

ARSIMI
I MEŠËM
I ULËT



DORACAK I KURRIKULËS SË
MËSIMDHËNIES PËR PAQË
DHE NDËRTIM TË QËNDRUESHMËRISË
(RESILIENCE)



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria e Kosovës-Vlada Kosova-Government of Kosova
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
Ministarstvo Obrazovanja Nauke i Tehnologije
Ministry of Education, Science and Technology

DORACAK I KURRIKULËS SË
MËSIMDHËNIES PËR PAQE
DHE NDËRTIM TË QËNDRUESHMËRISË
(RESILIENCE)

ARSIMI I MESËM I ULËT

Prishtinë 2020

DORACAK I KURRIKULËS SË MËSIMDHËNIES PËR PAQE DHE NDËRTIM TË QËNDRUESHMËRISË (RESILIENCE)

Autorët

Emma Founds, Specialiste Teknike për Parandalimin e Radikalizimit,
Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në Kosovë, financuar
nga USAID / Kosova përmes projektit Siguria dhe Rendi në Kosovë (KSSP)

Feime Llapashtica-Lipscomb, Shqipe Gashi-Ramadani, Arbër Salihu,
Divizioni për Kurrikula dhe Mbështetje të Mësuesve në Ministrin e Arsimit,
Shkencës dhe Teknologjisë Kosovë

Kontribues

Save the Children
forumZFD

Play International

Qendra për Arsim e Kosovës (QAK)

Shkollat që morën pjesë

Gjimnazi "Ahmet Gashi", Prishtinë
Sh.F.M.U. "Pjetër Bogdani", Prishtinë
Gjimnazi "Remzi Ademaj", Prizren
Sh.F.M.U. "Dëshmorët e Kabashit", Korishë
Sh.F.M.U. "Rexhep Elmazi", Gjilan
Gjimnazi "Zenel Hajdini", Gjilan
Gjimnazi "Skënderbeu", Kaçanik
Sh.F.M.U. "Jusuf Gërvalla", Biqec

Ky doracak është hartuar dhe shtypur në partneritet me UNDP dhe USAID.

Ky doracak është dizajnuar dhe përkthyer në partneritet me forumZFD, që mbështetet nga Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ).

Mohim i përgjegjës: Përbajtja e këtij doracaku nuk pasqyron detyrimisht opinionet e UNDP-së apo të donatorit tonë, USAID-it, as të Qeverisë së SHBA-ve.



1

Hyrje

	7
■ Pritshmëritë	7
■ Mësimdhënia për paqe dhe shpjegimi i ndërtim të qëndrueshmërisë	8
■ Dokumente kurrikulare: Çështjet ndërkurrikulare	10
■ Dokumente kurrikulare: Korniza Kurrikulare	12
■ Dokumente kurrikulare: Kurrikula bërthamë	13
■ Dokumente kurrikulare: Kurrikulat lëndore/programet mësimore	14
■ Struktura e moduleve	14
■ Lista kontrolluese e planifikimit të mësimi	16
■ Udhëzuesi kurrikular (për çështjen ndërkurrikulare)	16

2

Modulet e mësimave (njësive mësimore)

	19
■ Globalizimi dhe ndërvarësia // Klubet e Gjelbra	19
■ Edukimi për qytetari demokratike // Të drejtat e njeriut	25
■ Edukimi për paqe // Ndërmjetësimi	31
■ Edukimi për paqe // Pranimi dhe gjithëpërfshirja	37
■ Edukimi për media // Siguria në media sociale	51
■ Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm // Zvogëlimi i rrezikut nga katastrofat	61

3

Organizatrat dhe burimet e tjera shtesë

75

ARSIMI I MËSËM I ULET

Pritshmëritë

Shpjegimi i mësimdhënies për paqe
dhe ndërtim të qëndrueshmërisë

Dokumente kurrikulare: Çështjet ndërkurrikulare

Dokumente kurrikulare: Korniza Kurrikulare


Dokumente kurrikulare: Kurrikula bërthamë

Dokumente kurrikulare: Kurrikulat lëndore/programet mësimore

Struktura e moduleve

Lista kontrolluese e planifikimit të mësimi

Udhëzuesi kurrikular (për çështjen ndërkurrikulare)



HYRJE:

DORACAKU I KURRIKULËS PËR MËSIMDHËNIE PËR PAQE DHE NDËRTIM TË QËNDRUESHMËRISË (RESILIENCE-S)

Ky dokument synon të sjellë mjete dhe shembuj që mesimdhënësit t'i përfshijnë temat e paqes dhe ndërtimit të qëndrueshmërisë si pjesë e çështjeve/temave ndërkurrikulare që kërkohen nga Korniza Kurrikulare e Kosovës dhe Kurrikula Bërthamë (që bashkërisht referohen si “dokumente kurrikulare”). Mësimdhënësve do t'u jepjen mjete praktike për t'i ndërlidhur drejtpërdrejt materialet dhe burimet ekzistuese me temat e duhura në Kurrikulën Bërthamë, për të mbështetur zhvillimin e rezultateve të të nxënësve për fusha (RNF) dhe rezultatet e të nxënësve për kompetenca (RNK). Organizata të ndryshme kanë bashkëpunuar me

Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) për të krijuar këtë dokument duke adresuar një shumëllojshmëri të temave që gjithashtu përfshihen në çështjet/temat ndërkurrikulare. Jepen hollësi të tjera lidhur me qëllimet e këtij doracak, si dhe sqarohen konceptet e paqes dhe ndërtimit të qëndrueshmërisë (resilience-s), të përcjella nga një vështrim i përgjithshëm i dokumenteve kurrikulare të Kosovës dhe së fundmi, shtjellohet struktura e moduleve.

PRITSHMËRITË

Modulet e paraqitura këtu sjellin shembuj se si mesimdhënësit mund t'i përdorin materialet dhe burimet që janë të gatshme për t'i përkrahur nxënësit që të arrijnë caqet/rezultatet e përcaktuara me Kurrikulën Bërthamë. Shembujt e përdorur nuk janë të plotë apo përshtues, por kanë për qëllim të paraqesin se si informacioni dhe aktivitetet e përfshira në një sërë doracakësh dhe burimesh mund të ndërlidhen me rezultatet dhe qëllimet e dokumenteve kurrikulare të Kosovës.

Ky doracak kurrikular ndihmon për t'u siguruar se mesimdhënësit kanë mjetet e nevojshme për të:

- ☞ nxitur shkathhtësitë, vlerat dhe njohuritë e nxënësve që:
- ☞ përkrahin kulturën e paqes dhe ndërtimin e qëndrueshmërisë (resilience-s) së nxënësve,
- ☞ pra nxënësit, shkollat, familjet dhe komunitetet të jenë më të sigurta, të mbrojtura dhe më të afta për të reaguar ndaj sfidave që paraqiten.

Promovimi i kulturës së jodhunës dhe nxitja e ndërtimit të qëndrueshmërisë (resilience-s) te

secili nxënës trajtohet përmes çështjeve/temave ndërkurrikulare, ku mund të ketë ripërsëritje apo përbërës të ndërlidhur, përfshirë: edukimin për qytetari demokratike, edukimin për paqe, globalizimin dhe ndërvarësinë, edukimin për media, edukimin për zhvillim të qëndrueshëm. Për dallim nga një model i pamjaftueshëm, doracakët e kurrikulës për Mësimdhënie për Paqe dhe Ndërtim të Qëndrueshmërisë (Resilience-s) përqendrohen tek ndërtimi i aseteve të nxënësit që nxisin ndërtimin e qëndrueshmërisë, vlerat demokratike, barazinë dhe paqen duke promovuar qasjen pjesëmarrjen dhe qasjen me nxënësin në qendër në përputhje me Kornizën Kurrikulare. Kjo qasje pozitive mbështetet nga hulumtimet me bazë të fortë në një shumëllojshmëri të fushave si psikologjia, puna sociale dhe kujdesi shëndetësor që prej kohësh kanë tentuar të parandalojnë përfshirjen e nxënësve në sjellje të rrezikshme. Kur zbatohet nga mesimdhënësit në klasë, përmbajtja e çështjes ndërkurrikulare për Mësimdhënie për Paqe dhe Ndërtim të Qëndrueshmërisë mund të ndihmojë nxënësit që zhvillojnë shkathhtësitë dhe njohuritë që të analizojnë në mënyrë konstruktive mesazhet që pranojnë dhe t'i qasen konflikteve në mënyrë efektive. Kjo mund t'i kontribuojë

¹ Për shembull, shih Zimmerman, Marc A. “Resiliency theory: a strengths-based approach to research and practice for adolescent health” Health education & behavior: the official publication of the Society for Public Health Education vol. 40,4 (2013): 381-3.

Qëndrueshmërisë mund të ndihmojë që nxënësve t'u japë shkathtësitë dhe njohuritë që të analizojnë në mënyrë konstruktive mesazhet që pranojnë dhe t'i qasen konflikteve në mënyrë efektive. Kjo mund t'i kontribuojë parandalimit të përjashtimit social, bullizmit, përdorimit të drogës dhe alkoolit, ksenofobisë, radikalizimit dhe shumë dukurive të tjera negative.

Edhe pse në qendër të këtyre materialeve janë temat pozitive, mësimdhënësit duhet të familjarizohen me mënyrën se si të trajtojnë çështjet sfiduese ose të vështira si pjesë e diskutimeve gjithëpërfshirëse me nxënësit. Nxënësit përballen me një sërë sfidash bashkëkohore dhe me gjasë do të kenë pyetje


lidhur me çështje të tilla dhe mësimdhënësit dhe administratorët e shkollave kanë një pozitë dhe rol të veçantë dhe të rëndësishëm për të nxitur zhvillimin e nxënësve. Konteksti individual dhe gjykimi profesional do të diktojnë se si këto tema mund të trajtohen si duhet me nxënësit tuaj. Përmendja apo diskutimi i temave “negative” nuk duhet të shmanget, mirëpo nuk duhet as të jenë fokusi kryesor pasi kjo mund të bëhet kundër produktive dhe t'i inkurajojë nxënësit që kërkojnë vëmendje apo që janë në kërkim të një identiteti për vete që të tërhiqen drejt sjelljeve të tilla negative dhe të rrezikshme. Këtu janë përfshirë dhe burime të sugjeruara për mësimdhënësit që të hulumtojnë më shumë për këto fusha.



MËSIMDHËNIA PËR PAQE DHE SHPJEGIMI I NDËRTIMIT TË QËNDRUESHMËRISË

Paqja dhe ndërtimi i qëndrueshmërisë janë përbërës thelbësorë pasi shërbejnë si qëllim i përbashkët i të gjitha çështjeve/temave ndërkurrikulare. Edhe pse mund të duket se paqja dhe ndërtimi i qëndrueshmërisë mund të trajtohen vetëm përmes çështjes/temës ndërkurrikulare të arsimit për paqe, kultura e paqes kërkon një sërë vlerash, qëndrimesh

dhe sjelljesh që duhen trajtuar përmes të gjitha çështjeve/temave ndërkurrikulare që paraqiten në dokumentet kurrikulare. Për t'i sqaruar këto koncepte, lidhjet ndërmjet kulturës së paqes (dhe rreziqeve me të cilat përballen nxënësit) dhe ndërtimit të qëndrueshmërisë do të eksplorojnë duke trajtuar këto pyetje:



Duke qenë se termi “paqe” ka kuptim të gjerë që mbulon një shkallë të gjerë të këndvështrimeve, ky doracak thjesht i referohet **Deklaratës së Kombeve të Bashkuara dhe Programit për Veprim për Kulturën e Paqes (“Deklarata e**

OKB-së”) për të sjellë kornizën e nxitjes së kulturës së paqes². Ashtu si shtjellohet më tej në Programin për Veprim, paqja mund të përkufizohet jo vetëm si mungesa e konfliktit, por edhe kërkon:

² “Deklarata dhe programi për Veprim mbi Kulturën e Paqes.” A/RES/61/295 - F, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, 16 tetor 1999, undocs.org/A/RES/53/243.

Proces pozitiv,
të pjesëmarrjes
dinamike

Ku dialogu
inkurajohet, dhe

Konfliktet zgjidhen
në frymë të
mirëkuptimit dhe
bashkëpunimit të
përbashkët.

Deklarata e OKB-së paraqet "vlerat, qëndrimet, traditat dhe modelet e sjelljes dhe mënyrës së jetesës që përbëjnë kulturën e paqes, përfshirë³:

a

Respekti për jetë, dhënia fund dhunës dhe promovimi dhe praktikimi i jodhunës përmes arsimit, dialogut dhe bashkëpunimit;

b

Respekt të plotë për parimet e sovranitetit, integritetit territorial dhe pavarësisë politike të Shteteve dhe mosndërhyrje në çështje që janë tërësisht brenda juridiksionit të secilit Shtet, në përputhje me Kartën e Kombeve të Bashkuara dhe të drejtën ndërkombëtare;

c

Respekt të plotë për dhe promovim të të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut;

d

Zotim për zgjidhje paqësore të konflikteve;

e

Përpjekje për të përmbushur nevojat zhvillimore dhe mjedisore të brezave të tashëm dhe të ardhshëm;

f

Respekt për dhe promovim të së drejtës për zhvillim;

g

Respekt për dhe promovim të të drejtave dhe mundësive të barabarta për gratë dhe burrat;

h

Respekt për dhe promovim të të drejtës së secilit për liri të shprehjes, mendimit dhe informacionit;

i

Respektim të parimeve të lirisë, drejtësisë, demokracisë, tolerancës, solidaritetit, bashkëpunimit, pluralizmit, diversitetit kulturor, dialogut dhe të kuptuarit ndërmjet të gjitha niveleve të shoqërisë dhe kombeve; nxitur nga mjedisi mundësues kombëtare dhe ndërkombëtar që ushqen paqen.

Përfshirja e koncepteve të lartpërmendura si pjesë e të nxënësve dhe diskutimeve në klasë ndihmon për fuqizimin e kompetencave të nxënësve që kërkohen në Kornizën Kurrikulare. Këto kompetenca kanalizojnë dhe rrisin fuqinë vepruese, aftësitë e liderimit dhe vetëbesimin e nxënësve duke i kontribuar kështu ndërtimit të qëndrueshmërisë së tyre. Qëndrueshmëria

mund të përkufizohet thjesht si aftësia për ta rimarrë veten shpejt nga vështirësitë dhe sfidat. Individët me qëndrueshmëri të ndërtuar kanë aftësinë të rimarrin veten dhe të përshtaten me katastrofa, konflikt dhe janë më shumë në gjendje të "rikthehen në vend" nga sfidat e jetës. Shkollat kanë mundësi të rëndësishme që të fuqizojnë ndërtimin e qëndrueshmërisë së

³ Id. Neni I

nxënësve, sepse qëndrueshmëria mund të formohet përmes përvojave dhe mundësive për mësim. Në nivel praktik, nxënësit do të fuqizohen për të marrë vendime të shëndetshme lidhur me sjellje të rrezikshme dhe do të posedojnë shkathtësitë për jetë që kërkohen për komunikim efektiv dhe zgjidhje të suksesshme të konflikteve. Paqja dhe ndërtimi i qëndrueshmërisë janë koncepte që fuqizojnë njëri-tjetrin. Kultura e paqes ndërton qëndrueshmërinë dhe po ashtu, ndërtimi i qëndrueshmërisë i kontribuon kulturës së paqes, sepse individët kanë më pak gjasa të përfshihen në dhunë për të zgjidhur mospajtime, individët janë të fuqizuar që të marrin vendime të

sigurta dhe të shëndetshme dhe nxënësit me qëndrueshmëri të ndërtuar i kontribuojnë qëndrueshmërisë së komunitetit duke luajtur role kyçe në promovimin e sigurisë dhe kohezionit social. Kultura e paqes ndihmon në sigurimin e ndërtimit të qëndrueshmërisë duke mundësuar edukim të gjithanshëm, mbështetje dhe rrjete e institucione gjithëpërfshirëse dhe u jep individëve mundësinë për angazhim qytetar. Për të mësuar se çfarë kërkohet për të krijuar kulturë të paqes dhe ndërtim të qëndrueshmërisë, dokumentet kurrikulare të Kosovës parashtrojnë çështjet ndërkurrikulare/temat e nevojshme.

Dimensionet e mësimdhënies për paqe dhe ndërtimit të qëndrueshmërisë



DOKUMENTET KURRIKULARE: ÇËSHTJET/TEMAT NDËRKURRIKULARE

Temat ndërkurrikulare përmbajnë çështje të rëndësishme të aktualitetit që janë identifikuar në politikat arsimore vendase dhe ndërkombëtare që duhet të integrohen në të gjitha fushat dhe

lëndët kurrikulare. Përshkrimet e mëposhtme janë pjesë të shkëputura nga dokumentet kurrikulare.⁴

⁴ Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, "Kurrikula e Kosovës, Kurrikula Bërthamë e Arsimit të Mesëm të Ulët të Kosovës" gusht 2016 dhe "Kurrikula e Kosovës, Kurrikula Kryesore e Arsimit të Mesëm të Lartë të Kosovës" gusht 2016.

Edukimi për qytetari demokratike

I referohet, njohjes dhe respektimit të të drejtave të njeriut përfshirë të drejtat e fëmijëve, çështjet gjinore, çështjet kulturore dhe ndërkulturore, LGBT-ë, parandalimit dhe lufimit të trafikimit, korrupsionit dhe çështje të tjera të ngjashme që cenojnë integritetin e individit në shoqëri, si dhe sundimit të ligjit.

Edukimi për paqe

I referohet kuptimit të diversiteteve në shoqëri si vlera shoqërore. Përmbajtjet për edukimin për paqe janë toleranca, harmonia dhe bashkëjetesa etnike, fetare, kulturore, racore, etj, dhe të jetuarit në harmoni me mjedisin natyror; lufta kundër terrorizimit, e drejta humanitare, dinjiteti njerëzor, ndalimi i dhunës, parandalimi dhe zgjidhja e konflikteve.

Globalizimi dhe ndërvarësia

I referohet shndërrimit të ekonomive nacionale në ekonomi globale – botërore, bashkëveprimet, kombinimit të aftësive dhe mundësive për të krijuar gjera të përbashkëta, kombinimit të përpjekjeve me të tjerët për të arritur suksese më të mëdha, për të bashkëpunuar dhe zhvilluar qytetërimet, etj. Tema e globalizimit dhe ndërvarësisë përfshijnë përmbajtjet lidhur me çështjet mjedisore, çështjet ekonomike, arsimore, shëndetësore, proceset e integritit evropian, marrëveshjet ndërkombëtare, çështjet politike dhe agjendat ndërkombëtare, sistemin e rrjeteve të informimit dhe teknologjisë, etj.

Edukimi për media

I referohet përdorimit të medieve për sigurimin e informacioneve të reja dhe të drejta, krijimin dhe përdorimin e informatave, komunikimin përmes medieve tradicionale dhe digjitale, kritikën ndaj medieve, gjuhën e medieve dhe ndikimin e saj në shoqëri, pritjet e qytetarëve nga mediet dhe përdorimit të drejtë dhe të sigurtë të tyre etj. Çështja e edukimit për media përfshin përmbajtjet lidhur me mediet tradicionale dhe digjitale, televizionin, radion, filmin, gazetatat, revistat, internetin, fotografitë, reklamat dhe lojërat elektronike, etikën në media, etj.

Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm



I referohet temave me rëndësi të përgjithshme të cilat ndikojnë në ndërgjegjësimin e të rinjve/nxënësve për një qëndrim aktiv ndaj çështjeve dhe dukurive mjedisore, në nivel lokal dhe global. Këtu hyjnë çështjet si ndikimi i aktivitetit të njeriut në cilësinë e mjedisit, ngrohjen globale, biodiversitetin, energjia e ripërtëritshme etj. Çështjet e zhvillimit të qëndrueshëm çështjet e realizimit të së drejtës për të jetuar në mjedis të shëndoshë dhe në mirëqenie sociale bazuar në konventat ndërkombëtare. Përveç realizimit të së drejtës për mjedis të shëndetshëm ndërliidhet edhe me filozofinë e shfrytëzimit të burimeve mjedisore si trashëgimi e brezit të ardhshëm.

SHËNIM:

Shënim: këto çështje/tema janë të ndërlidhura ngushtë dhe përkrahin njëra-tjetrën. Ato dallojnë në fokus dhe fushëveprim dhe jo në qëllime apo praktika.

DOKUMENTE KURRIKULARE: KORNIZA KURRIKULARE

Korniza Kurrikulare përmban 6 kompetenca kryesore që nxënësit duhet të demonstrojnë pas përfundimit të arsimit të detyrueshëm se kanë përfituar njohuritë dhe shkathtësitë thelbësore për pjesëmarrje të plotë në shoqëri. Këtu përfshihen:



⁵ Në vitin 2018, Programi i modifikuar i OECD-së për Vlerësimin Ndërkombëtar të Nxënësve (PISA) testoi përfshirjen e kompetencës globale të cilën OECD-ja e përshkruan si aftësia për të "kuptuar dhe vlerësuar këndvështrimet dhe pikëpamjet për botën e të tjerëve, për t'u përfshirë në ndërveprime të hapura, të përshtatshme dhe efektive me njerëz nga kultura të ndryshme dhe për të vepruar për mirëqenie kolektive dhe zhvillim të qëndrueshëm."

Sistemi Arsimor i Kosovës përdor një qasje me 4 shtresa për të ndërlidhur temat specifike me Rezultatet në Lëndë (që mbështeten nga Rezultatet Ndërkurrikulare të çështjeve/temave ndërkurrikulare) të cilat rrjedhin nga Rezultatet e

të Nxënit të Fushës të Kurrikulës Bërthamë (RNF). RNF-të bazohen në kërkesat e nevojshme për arritjen e 6 kompetencave kryesore (Rezultatet e të Nxënit për Kompetenca (RNK)).

DOKUMENTET KURRIKULARE: KURRIKULA BËRTHAMË

Në bazë të Kornizës Kurrikulare, Kurrikulat Bërthamë mbulojnë tri nivele: (klasën përgatitore dhe arsimin fillor, arsimin e mesëm i ulët dhe arsimin e mesëm të lartë). Secili dokument i Kurrikulës Bërthamë përmban rezultatet e të nxënit për fusha kurrikulare, përfshirë njohuri

specifike, qëndrime, vlera dhe shkathtësi që mësime dhëniesit duhet të mbështesin (nxëniesit) përmes dhënies së mësimit në lëndën e tyre të caktuar. Ky doracak kurrikular përmban materiale që lidhen me dokumentat e Kurrikulës Bërthamë për Nivelin 2 dhe ndaras për Nivelin 3.

Niveli 2:

Kurrikula Bërthamë për
Arsimin e Mesëm të Ulët,
Shkallët kryesore
kurrikulare 3&4: **klasët
VI, VII, VIII dhe IX
(mosha 11-14 vjeç)**

Niveli 3:

Kurrikula Bërthamë për Arsimin
e Mesëm të Lartë, Shkallët
kryesore kurrikulare 5&6:
**klasët X, XI, XII (gjimnazet
dhe shkollat profesionale)
(mosha 15-17/18 vjeç)**

Arsimi parauniversitar ka 7 fusha kurrikulare:

- ▶ GJUHËT DHE KOMUNIKIMI
- ▶ ARTET
- ▶ MATEMATIKA
- ▶ SHKENCAT NATYRORE
- ▶ SHOQËRIA DHE MJEDISI
- ▶ EDUKATA FIZIKE,
SPORTET DHE SHËNDETI
- ▶ JETA DHE PUNA

DOKUMENTA KURRIKULARË: Kurrikulat lëndore /programet mësimore

Planprogrami mësimor mbështet Kurrikulën Bërthamë dhe Kornizën Kurrikulare. Për secilën nga 7 fushat kurrikulare ka lëndë të shumta. Mësimdhënësit duhet të zhvillojnë programin mësimor për secilën lëndë mësimore. Programi mësimor përfshinë rezultatet e lëndës për të

mbështetur direkt zhvillimin e RNF-venë dokumentat e Kurrikulës Bërthamë, që nga ana e vet mbështesin RNK të paraqitur në Kornizën Kurrikulare. Rezultatet ndërkurrikulare përkrahin arritjet e nxënësve dhe duhet të ndërlidhen me rezultate të lëndëve mësimore.

STRUKTURA E MODULEVE

Modulet grupohen sipas çështjeve/temave ndërkurrikulare, si edukimi për paqe, dhe përmbajnë shembuj të mësimëve në bazë të temës kryesore për paqe dhe ndërtim të qëndrueshmërisë që trajtohet, si diversiteti dhe gjithëpërfshirja (shih Udhëzuesin Kurrikular). Para mbajtjes së mësimit, shqyrtoni se çfarë njohurish apo informatash shtesë paraprake duhet të përfitojnë nxënësit.

Mësimdhënësit duhet të përfshijnë rezultatet e çështjes ndërkurrikulare në kuadër të rezultateve të lëndës. Këto mund të përshtaten nga materialet dhe doracakët ekzistues thjesht duke përshtatur gjuhën e qëllimeve dhe synimeve që zakonisht gjenden brenda atyre materialeve.

Secili mësim përmban një referencë ku mund të gjenden mësimet dhe informata shtesë. Mësimdhënësit duhet të përdorin burimet ekzistuese përveç tekstet shkollore si pjesë e planeve të tyre mësimore. Edhe pse jepen shembuj dhe sugjerime të burimeve, online mund të gjenden shumëllojshmëri e materialeve dhe po ashtu ato mund t'i kërkonit direkt nga organizatat.

Secili modul përmban një tabelë me **Lidhje Kurrikulare**:

- ◆ Kjo tabelë paraqet shembuj se si një sërë materialesh dhe temash mund të përfshihen si pjesë e çështjeve/temave ndërkurrikulare në disa fusha kurrikulare. Për shembull, diversiteti dhe gjithëpërfshirja mund të trajtohen në fushat e gjuhës dhe komunikimit, shoqërisë dhe mjedisit, dhe matematikës.
- ◆ Disa mësimet përmbajnë edhe lidhje në disa lëndë të caktuara brenda një fushe më të zgjeruar për të ilustruar se si mësimdhënësit mund të zhvillojnë më tej lidhjet me një lëndë të caktuar.
- ◆ RNF dhe RNK duhet të identifikohen për të lidhur secilin aktivitet në materiale direkt me Kurrikulën Bërthamë.

Shënim: të gjithë RNF-të dhe RNK-të në mësimet nxirren direkt nga dokumentat e Kurrikulës Bërthamë. Numrat, edhe pse mund të duken sikur janë jashtë radhës së mësimëve të përfshira këtu, i referohen direkt numërave sipas Kurrikulës Bërthamë. Po ashtu, formulimet e RNF dhe RNK janë marrë direkt nga Kurrikula Bërthamë për të lehtësuar përdorimin e këtij doracaku.

Aktivitetet sugjerohen brenda secilit mësim. Disa aktivitete nxirren direkt nga materiali mësimor, por mësimdhënësit duhet të modifikojnë, përshtasin dhe shtojnë aktivitete të reja relevante me përmbajtjen e mësimëve. Në këtë mënyrë, një shumëllojshmëri e udhëzimeve, rekomandimeve dhe burimeve të tjera mund të përfshihen si pjesë e çdo plani të orës mësimor.

VËRENI

Vëreni se fushat kurrikulare/lëndët mësimore mund të citojnë burim(e) shtesë në kuadër të mësimin për të forcuar dhe më tej informacionin paraprak dhe/ose aktivitetet e shpalosura në materialin parësor burimor.

Lidhjet me kurrikulën

Çdo material mund të lidhet me më shumë se një fushë kurrikulare. Secili modul paraqet 2-3 shembuj se si materiali mund të mbështesë lëndë të ndryshme mësimore. Këta janë vetëm shembuj dhe nuk paraqesin secilën fushë kurrikulare me të cilën mund të ndërlidhen materialet. Disa mësimë përmbajnë lidhje edhe me lëndë të caktuara mësimore.

RNK gjenden në dokumentat kurrikulare. Sigurohuni të përdorni Shkallë kryesore kurrikulare të saktë.

Fushat e kurrikulës dhe shkalla kryesore kurrikulare

Aktivitetet

Rezultatet e të nxënit për secilën fushë

Rezultatet e të nxënit për kompetenca

Aktivitetet përshkruhen në material, është në dorë të mësimdhënësit të vendosë se cilat aktivitete janë relevante për përmbajtjen e lëndës.

Mësimdhënësit duhet të përcaktojnë shkallët kryesore kurrikulare dhe të përshtasin aktivitetet sipas nevojës. Një material mësimor mund të përshtatet për shkallë të ndryshme kryesore kurrikulare.

LISTA KONTROLLUESE E PLANIFIKIMIT TË MËSIMIT

A i kanë nxënësit njohuritë e kërkuara për mësimin (njësinë mësimore)?



Gjatë planifikimeve të orëve mësimore në koordinim edhe me mësimdhënës të tjerë në shkollën tuaj duhet të siguroheni se nxënësit kanë **njohuritë e kërkuara** para se të mbuloni tema më komplekse. Për shembull, para se të shtjelloni temën e diversitetit dhe gjithëpërfshirjes, nxënësit duhet të familjarizohen me përkufizimet dhe konventat për të drejtat e njeriut.

A janë koordinuar aktivitetet /departamentet profesionale sa i përket çështjeve/temave ndërkurrikulare?



Çështjet /Temat ndërkurrikulare integrohen në lëndë dhe njësi mësimore. Prandaj, **nuk ka orar të paracaktuar** për zbatimin e temave ndërkurrikulare. Sidoqoftë, mësimdhënësit duhet të punojnë bashkë nëpër aktive/departamente profesionale për planifikimin e kurrikulës për t'u siguruar se të gjitha temat relevante trajtohen si duhet dhe ashtu si kërkohet nga dokumentet kurrikulare.

A kanë punuar mësimdhënësit bashkërisht gjatë planifikimit për të ndërlidhur materialet e sugjeruara me secilën klasë dhe lëndë?



Në doracak janë përfshirë **dy lloje të modeleve**: njëri përfshin lidhje me fushat kurrikulare, ndërsa modeli tjetër sjell lidhje me lëndë mësimore specifike. Mësimdhënësit do të punojnë bashkërisht gjatë planifikimit për të përzgjedhur lëndët që lidhen më mirë me secilin mësim (njësi mësimore).

UDHËZUESI KURRIKULAR (për çështjen ndërkurrikulare)

Tabela në vijim paraqet kurrikulën e sugjeruar për Mësimdhënia për Paqe dhe Ndërtim të Qëndrueshmërisë si pjesë e çështjeve /temave ndërkurrikulare. Edhe pse shembujt e mësimëve të përfshira në këtë doracak mbulojnë shumë

aspekte të secilës temë ndërkurrikulare, materialet dhe burimet shpesh sugjerohen në **“Kontakte për organizata dhe burime shpeshë”** në faqen 81 - 85 të cilat mund të zgjerojnë dhe fuqizojnë këto tema:

Çështjet/Temat ndërkurrikulare	Tema për paqen dhe ndërtimin e qëndrueshmërisë
Globalizimi dhe ndërvarësia	Qytetaria globale Kulturat botërore dhe kontributi i tyre Varfëria Shëndeti dhe mirëqenia
Edukimi për qytetari demokratike	Gjinia (historike, kulturore, socio-ekonomike) Pjesëmarrja Lidershipi demokratik Qeverisja e mirë, llogaridhënia, transparenca Avokimi dhe angazhimi civil Të drejtat dhe konventat ndërkombëtare Të drejtat e njeriut: civile, shoqërore, ekonomike, politike, kulturore Shkelja e të drejtave Diskriminimi mbi baza të seksit, fesë, etnisë, statusit ekonomik Trajtimi i ankesave (globale, lokale, nivel të shkollës)
Edukimi për paqe	Diversiteti dhe identiteti Toleranca Radikalizimi dhe ekstremizmi i dhunshëm Menaxhimi i emocioneve Zgjidhja e problemeve Të dëgjuarit aktiv Të kuptuarit e mendimeve të ndryshme Pajtimi Parandalimi i dhunës Pranimi dhe gjithëpërfshirja Ndërmjetësimi Vendimmarrja (drogat dhe alkooli, sjellje të tjera të rrezikshme) Vetëvlerësimi Menaxhimi i stresit Puna ekipore Presioni nga bashkëmoshatarët Komunikimi i sinqertë Roli i nxënësve në ndërtimin e paqes Bullizmi (ngucakeqja)
Edukimi për media	Reklamat dhe ndikimi i tyre Shkathtësi për informacion dhe biblioteka Përdorimi etik i informacionit Roli i medias në nxënie, dialog ndërkulturor, shoqëri demokratike Ruajtja e informacionit dhe sistemet e organizimit Kthimi i mesazheve Mbledhja dhe prezantimi i të dhënave Reputacioni dhe bullizmi kibernetik Siguria në media sociale
Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm	Hyrje në zhvillimin e qëndrueshëm Arsimi për qëllimet e zhvillimit të qëndrueshëm Reduktimi i rrezikut nga katastrofat Zhvillimi i komunitetit

ARSIMI I MESHËM I ULET

Globalizimi dhe ndërvarësia
// **Klubet e Gjelbra**

Edukimi për qytetari demokratike
// **Të drejtat e njeriut**

Edukimi për paqe
// **Ndërmjetësimi**

Edukimi për paqe
// **Pranimi dhe gjithëpërfshirja**

Edukimi për media
// **Siguria në media sociale**

Arsimit për zhvillim të qëndrueshëm
// **Ulja e rrezikut nga katastrofat**

Temat për paqe dhe ndërtim të qëndrueshmërisë

- ◆ Shëndeti dhe mirëqenia
- ◆ Qytetaria globale
- ◆ Varfëria

Rezultatet ndërkurrikulare

- ◆ Identifikojnë fushat për ndërhyrje të përbashkët.
- ◆ Analizojnë gjendjen e mjedisit në lokacionin e shkollës.
- ◆ Ofrojnë alternativa për zgjidhjen e situatave të ndryshme kur të drejtat e njeriut dhe mirëqenia shkelen.



BURIMI

QAK,
"Klubet e Gjelbra
– Udhëzime
praktike për
shkollat"

Lidhjet me Kurrikulën Bërthamë

Fushat e kurrikulës dhe shkalla kryesore	Aktivitetet	Rezultatet e të nxënit për secilën fushë	Rezultatet e të nxënit për kompetenca
Shkencat e natyrës, Shkalla 4	Nxënësit mund të eksplorojnë rolin, qëndrimet dhe pikëpamjet e veta lidhur me ruajtjen e mjedisit, mësime dhënësit mund të përshtasin mësimin duke përfshirë eksperimente shkencore.	<p>I. Njohuri, të kuptuar dhe zhvillim i shkathtësive përmes procesit të të nxënit:</p> <p>2. Strukturim i mendimit shkencor për koncepte, modele, teori dhe ligje për përbërjen e materies, proceseve dhe dukurive në natyrë (proceset dhe dukuritë fizike, kimike, biologjike të Tokës dhe universit).</p> <p>1. Shkathtësi huluntuese në Shkenca Vlerëson rrezikun para fillimit të punës praktike nga mjedisi dhe mjetet që përdor.</p> <p>Prezanton konkluzionet e hulumtimit/eksperimentit duke i arsyetuar me dëshmi të mjaftueshme.</p>	<p>Qytetari përgjegjshëm Identifikon shkaqet dhe efektet e dëmtimit të mjedisit, në shkollë ose komunitet, mban qëndrim ndaj tyre dhe propozon veprime konkrete për t'i luftuar.</p> <p>Komunikues efektiv Shpjegon qartë dhe saktë, me fjalë ose me shkrim, kuptimin e termave të reja (fjalë, koncepte), duke përdorur gjuhë dhe fjalor të përshtatshëm dhe të saktë.</p>

<p>Shoqëria dhe mjedisi, Shkalla 3</p>	<p>Nxënësi analizon situatën rreth shkollës për të përgatitur planin për veprim.</p>	<p>4. Jep ide dhe propozime si dhe merr vendime në mënyrë të vetëdijshme dhe të përgjegjshme 4.1 Vlerëson ndikimin e vendimmarrjes individuale, grupore e institucionale në kohë dhe vende të ndryshme, krijon qëndrime personale për to dhe i përdor në jetën e tij të përditshme.</p> <p>4.2 Tregon kujdes, respekt e përgjegjshmëri për vendimmarrjen e drejtë në aktivitetet ku është i përfshirë (në shkollë, bashkësi dhe më gjerë).</p> <p>5. Kontribuon në ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit si dhe në zhvillimin e qëndrueshëm 5.1 Inicion aktivitete konkrete grupore me qëllim të ngritjes së vetëdijes së bashkësisë për ruajtjen dhe zhvillimin e mjedisit jetësor.</p>	<p>II. Mendimtar kreativ dhe kritik 3. Analizon një punim artistik ose joartistik (p.sh., artikull gazetaresk, pikturë... etj.) duke gjetur analogji dhe dallime me punime të ngjashme nga autorë të ndryshëm).</p> <p>IV. Kontribuues produktiv 2. Ndërmerr aktivitete të ndryshme (ekspozitë, performancë, instalacion, fushatë, protestë paqësore, tubim, avokim etj.) në bazë të projektit, të hartuar me anëtarët e grupit, për zgjidhjen e një problemi me rëndësi shoqërore, për shkollën ose për komunitetin.</p> <p>3. Diskuton me bashkëmoshatarë rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit, pasojat për jetën e njeriut që shkaktohen nga dëmtimi i mjedisit dhe sugjeron masa që duhen marrë për t'i shmangur.</p>
<p>Matematika, Shkalla 3</p>	<p>Nxënësit diskutojnë dhe analizojnë çështje të mjedisit dhe rëndësinë e aktivizmit qytetar. Burime ose hulumtime shitesë mund të plotësojnë aktivitetet e Klubit të Gjelbër që mësimi të përshtatet me lëndën.</p>	<p>4. Lidhje me matematikën 1. Bën lidhjen mes koncepteve dhe procedurave matematikore.</p> <p>2. Integron njohuritë dhe shkathtësitë matematikore që përftohen nga situata ose ndodhur në kontekste të tjera (jeta e përditshme, lëndë, sporte etj.).</p>	<p>III. Nxënës i suksesshëm 2. Shfrytëzon të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve numerike, grafike, simboleve, formulave në shkencë natyrore dhe shoqërore, në matematikë ose arte duke i sqaruar në forma të ndryshme të të shprehurit.</p> <p>5. Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat</p>

3. Integron/lidh koncepte të ndryshme matematikore për të zgjidhur probleme të ndryshme.

paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike.

7. I parashtron pyetje vetes (pse, çka, si, kur?) dhe organizon mendimet e veta në formë të shkruar për temën apo problemin e dhënë dhe vlerëson përparimin e vet derisa të gjejë zgjidhjen e duhur për problemin e caktuar.

* Këta janë disa nga shembujt që i lidhin këto materiale me kurrikulën



Sfondi

Përse ky fokus?

Qëllimi i Klubeve të Gjelbra është t'u japë nxënësve njohuritë, shkathtësitë dhe të kuptuarin përmes përvojave praktike lidhur me mjedisin e tyre, ndërveprimet me të dhe problemet që

hasen, si dhe të zhvillojnë shkathtësitë që kërkohen për vëzhgim, eksperimentim, hulumtim dhe regjistrim për të patur arsytim për mbrojtjen e mjedisit.

Klubet e Gjelbra ofrojnë këto mundësi:

- ◆ U japin nxënësve mundësinë të kuptojnë ndjenjën e avancimit të mjedisit në shkollë përmes përafrimit me kurrikulën, mësimdhënies dhe nxënies dhe partneritetit shkollë-komunitet.
- ◆ U japin nxënësve mundësinë të mësojnë për mjedisin që i rrethon dhe të marrin pjesë në projekte të shkollës dhe të komunitetit.
- ◆ Rrisin vetëdijësimin e nxënësve për mjedisin dhe zhvillojnë shkathtësitë sociale dhe për jetë.
- ◆ U japin nxënësve mundësinë të angazhohen në projekte të ndryshme që kanë të bëjnë me mjedisin.
- ◆ U japin nxënësve mundësinë të përdorin idetë e tyre për të vepruar dhe për t'i kontribuar ndryshimeve në shkollë.



Përshkrimi i aktiviteteve -

Udhëzime për zbatim në klasë

Qëllimi i aktiviteteit është që fëmijët e shkollës të informohen për rolin dhe mandatin e Klubeve të Gjelbra. Kjo bëhet duke folur për përvojën e

shkollës "Hilmi Rakovica" në Prishtinë dhe shkollës "Selman Riza" në Fushë Kosovë.

Nxënësit e Klubit të Gjelbër në shkollën fillore “Hilmi Rakovica” në Prishtinë promovojnë sistemin e riciklimit

Prezantimi i praktikës së një shkolle:

Klubet e Gjelbra janë një nga metodat e reja për t'i aktivizuar nxënësit në nxënie dhe për t'i angazhuar në aktivitete praktike që përfshijnë kompetenca për zgjidhje të problemeve, të menduar kreativ dhe si ndërmarrës, shkathtësitë e komunikimit të TIK-ut dhe që i inkurajojnë ata të përdorin teknologji moderne të të nxënësve.

Programi BEP i USAID-it e ka përkrahur projektin e Klubeve të Gjelbra me anë të trajnimeve të mësimdhënësve, shpërndarjes së shtypësve të shisheve plastike dhe koshave metalikë për t'iu mundësuar të grumbullojnë dhe përpunojnë shisheet plastike të përdorura dhe për t'ua shitur ato më vonë kompanive të riciklimit.

Për të promovuar vendosjen dhe funksionimin e sistemit të riciklimit, nxënësit e Klubit të Gjelbër të shkollës fillore "Hilmi Rakovica" në Prishtinë kanë organizuar një program edukativo-artistik që përfshinte:

- ▶ **Ekspozitë artistike me sende dhe dizajne nga letra e ricikluar dhe postera me tematikë mjedisore;**
- ▶ **Videofilma për çështje mjedisore nga vetë nxënësit;**
- ▶ **Demonstrim të sistemeve të riciklimit për letër dhe shishe plastike të implementuar nga Klubi i Gjelbër dhe që u janë shitur një kompanie të riciklimit;**
- ▶ **Shfaqje e shkurtër teatrore me role të ndryshme lidhur me mjedisin ku luajtën vetë nxënësit.**

Pjesa teatrore që e luajtën këta aktorë të vegjël bëri përshtypje shumë të madhe dhe mesazhi i

saj ishte "që të jetojmë dhe të kujdesemi për mjedisin nuk është e pamundur, por thjesht kërkon ndryshim të të menduarit, sjelljes kolektive dhe praktikave të përditshme individuale. Ndryshimet e vogla mund të bëjnë dallime të mëdha".

Komuna e Fushë-Kosovës përkrah Klubin e Gjelbër në shkollën fillore dhe të mesme të ulët “Selman Riza”

Nxënësit e Klubit të Gjelbër në shkollën fillore “Selman Riza” po e zhvillojnë këtë qasje të përbashkët përmes përfshirjes aktive të komunitetit në aktivitetet shkollore. Pjesë e këtij bashkëpunimi është përkrahja nga Komuna për Klubin e Gjelbër të shkollës "Selman Riza" që përbëhet nga gjashtë kosha për riciklim dhe sipas tyre, kjo ndihmë do t'i mundësojë shkollës të ketë rol në procesin e riciklimit.

Me këtë rast, nxënësit e Klubit të Gjelbër përgatitën një program për të ftuarit dhe nxënësit e tjerë të shkollës. Me aktivitetet e tyre, nxënësit bënë thirrje për krijimin e Klubeve të Gjelbra edhe në shkolla të tjera dhe për organizimin e programeve të përbashkëta për mjedisin. Këto aktivitete të përbashkëta gjithashtu ndihmojnë në krijimin e një ndjenje të përbashkët të komunitetit duke fuqizuar shkathtësitë, shpirtin ekipor dhe dedikimin ndaj të gjithë shoqërisë.

Të gjithë, përfshirë shkollat dhe komunitetet, kontribuojnë për arritjen e rezultateve më të mira në zhvillimin e qëndrimeve pozitive ndaj mjedisit, mbrojtjes dhe ruajtjes së tij. Prindërit dhe komuniteti mund të mbështesin qëllimet e shkollës për mjedisin duke u bërë shembuj të sjelljes së duhur në shtëpi dhe duke përkrahur projektet për mjedis në shkollë.

Detyrat e nxënësve

Pas prezantimeve të praktikave më të mira të shkollave, nxënësit u ndanë në grupe për të hartuar plane të veprimit për shkollën dhe aktivitetet që do të ndërmerren në shkollë. Mësimdhënësi gjithashtu do të moderojë një diskutim për efektet globale që vijnë nga mosruajtja e mjedisit duke theksuar shembuj në nivel global.

Burime shtesë

QAK, "Klubet e Gjelbra – Udhëzime praktike për shkollat." Maj 2015.

2

Edukimi për qytetari demokratike
// **Të Drejtat e njeriut**

Temat për paqe dhe ndërtim të qëndrueshmërisë (resilience)

- ◆ Avokimi dhe angazhimi qytetar
- ◆ Të drejtat e njeriut: civile, shoqërore, ekonomike, politike, kulturore
- ◆ Shkelja e të drejtave
- ◆ Diskriminimi mbi bazën e seksit, fesë, etnisë, gjendjes ekonomike
- ◆ Trajtimi i ankesave (globale, lokale, në nivel të shkollës)

Rezultatet e çështjeve ndërkurrikulare

- ◆ Analizon situata jetësore që kanë të bëjnë me trajtim të pabarabartë në shoqëri.
- ◆ Identifikon palët e interesit që kanë interes të përbashkët lidhur me një çështje/problem specifik.
- ◆ Jep alternativa për të zgjidhur situata të ndryshme jetësore, ku janë shkelur të drejtat e njeriut.



BURIMI

QAK, "Edukimi për të drejtat e njeriut me fëmijët (doracak trajnimi)," janar 2010.

Lidhjet me Kurrikulën Bërthamë

Fushat e kurrikulës dhe shkalla kryesore	Aktivitetet	Rezultatet e të nxënësve për secilën fushë	Rezultatet e të nxënësve për kompetenca
Gjuhët dhe komunikimi, Shkalla 4	Gjatë mësimit, nxënësit diskutojnë dallimet në nevojat për arsim të fëmijëve (situata shoqërore komplekse).	<p>Të dëgjuarit dhe të folurit</p> <ul style="list-style-type: none"> - Konsultohet me bashkëmoshatarët dhe të rritur për tema të panjohura dhe situata shoqërore komplekse. - Debaton, analizon dhe argumenton për tema të ndryshme. <p>Lexon</p> <p>Kupton dhe analizon tema të ndryshme letrare dhe joletrare.</p> <p>Pasuron fjalorin</p> <p>Lexon dhe identifikon tipare strukturore të tekstit si heroina, personazhi, ideja, hollësia, imazhi, narracioni, përshkrimi.</p>	<p>I. Komunikues efektiv</p> <p>6. Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe të saktë.</p> <p>VI. Qytetar i përgjegjshëm</p> <p>1. Praktikton të drejtat dhe detyrimet qytetare në situata konkrete të jetës së përditshme, goftë në klasë, shkollë apo diku tjetër (si gjatë diskutimeve, tregon respekt për opinionin e të tjerëve etj.).</p> <p>6. Identifikon paragjykimet që mund të ekzistojnë në shkollë dhe në rrethinë si dhe propozon veprime konkrete për luftimin e tyre.</p>

<p>Shoqëria dhe mjedisi, Shkalla 3</p>	<p>Nxënësit diskutojnë dhe analizojnë pengesat në arsim dhe nëse shkolla dhe qeveria e tyre kanë respektuar të drejtat e tyre të njeriut lidhur me detyrimet ndaj të drejtës së fëmijëve për arsim.</p>	<p>3. Shqyrton në mënyrë kritike dhe zbaton normat dhe rregullat shoqërore përjetë të përbashkët në diversitet 3.2 Kupton dhe vlerëson llojllojshmërinë e kulturave, traditave, bashkësive të ndryshme dhe tregon tolerancë dhe respekt për to.</p> <p>4. Jep ide dhe propozime si dhe merr vendime në mënyrë të vetëdijshme dhe të përgjegjshme 4.1 Vlerëson ndikimin e vendimmarrjes individuale, grupore e institucionale në kohë dhe vende të ndryshme, krijon qëndrime personale për to dhe i përdor në jetën e tij të përditshme.</p> <p>4.2 Tregon kujdes, respekt e përgjegjshmëri për vendimmarrjen e drejtë në aktivitetet ku është i përfshirë (në shkollë, bashkësi dhe më gjerë).</p>	<p>VI. Qytetar i përgjegjshëm 5. Shpjegon, në formë të ndryshme të të shprehurit, domosdoshmërinë e respektimit dhe të zbatimit të rregullave dhe ligjeve për raportet e shëndosha në bashkësi të ndryshme shoqërore apo në grupe të interesit.</p> <p>6. Dëshmon vetëbesim të lartë në marrjen e vendimeve për veprimet që ndërmerr, pa i dëmtuar interesat e të tjerëve, të cilat kontribuojnë në rritjen e cilësisë së aktivitetit të grupit shoqëror apo të komunitetit.</p> <p>7. Identifikon paragjykimet që mund të ekzistojnë në shkollë dhe në rrethinë si dhe propozon veprime konkrete për luftimin e tyre.</p>
<p>Jeta dhe puna, Shkalla 3</p>	<p>Nxënësit mund të eksplorojnë rolin, qëndrimet dhe pikëpamjet e tyre lidhur me pabarazinë në shkollë dhe në shoqëri.</p>	<p>1. Ushtrimi i punës praktike në shtëpi, në shkollë dhe në komunitet 3. Zhvillon aktivitete praktike përmes punës me projekte në shkollë, shtëpi dhe në ambient të tjera jashtëshkollore.</p>	<p>IV. Kontribuues produktiv 2. Ndërmerr aktivitete të ndryshme (ekspozitë, performancë, instalacion, fushatë, protestë paqësore, tubim, avokim etj.) në bazë të projektit, të hartuar me anëtarët e grupit, për zgjidhjen e një problemi me rëndësi shoqërore, për shkollën ose për komunitetin.</p>

		<p>7. Përgatitja për jetën profesionale dhe karrierën e ardhshme</p> <p>1. Shfaq qëndrime vendimmarrëse në situata të ndryshme duke dhënë arsytim mbi vendimet që merr.</p> <p>9. Zhvillimi shoqëror, ekonomik dhe mjedisi.</p> <p>1. Adreson sfidat e së tashmes dhe të ardhmes në mënyrë konstruktive dhe kreative për të krijuar një shoqëri më të qëndrueshme.</p>	<p>6. Asiston në planifikimin dhe realizimin e aktiviteteve vullnetare ose humanitare në shkollë dhe komunitet dhe më pas shpreh përvojat, ndjenjat e veta me shkrim dhe forma të tjera të të shprehurit.</p> <p>7. Ndërvepron aktivisht me bashkëmoshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tyre shoqëror, etnik etj) për të zhvilluar aktivitete të përbashkët (projekti/aktiviteti në klasë/shkollë ose jashtë).</p>
--	--	--	--

* Këta janë disa nga shembujt që i lidhin këto materiale me kurrikulën

Sfondi

Qëllimi i këtij aktiviteti është që fëmijët të aktivizohen për të drejtat e njeriut. Më konkretisht, fëmijëve u paraqiten dy situata që kanë të bëjnë me gjithëpërfshirjen e fëmijëve nëpër shkolla. Situata e parë mbulon qasjen e fëmijëve më nevoja të veçanta në proceset arsimore, ndërsa e dyta merret me dhunën në mesin e bashkëmoshatarëve në shkollë dhe dallimet shoqërore.

Të dyja situatat japin materiale të bollshme për fëmijët që të zhvillojnë shkathtësitë e tyre analitike dhe krahasimore dhe t'u ndihmojnë të bëhen akterë relevantë në zgjidhjen e problemeve që ndodhin në shkollat tona.

Përshkrimi i aktiviteteve – udhëzime për realizimin në klasë

- ◆ Informoni fëmijët se si aktivistë për të drejtat e njeriut ata duhet të përfshihen në dy çështje. U tregoni atyre se do të punojnë në grupe më të vogla. Grupet krijohen në bazë të ditëlindjeve të pjesëmarrësve. Jepuni dy grupeve rastin e parë studimor të shkruar në letër, ndërsa dy grupeve të tjera do t'u jepet rasti i dytë studimor. Jepuni fëmijëve kohë të mjaftueshme për të lexuar rastet studimore.
- ◆ **Kërkoni nga fëmijët në grupet e tyre:**
 - ◆ Të diskutojnë gjendjen dhe të komentojnë nga perspektiva e të drejtave të njeriut,
 - ◆ Të identifikojnë të gjitha palët e interesit të përfshira në atë çështje,
 - ◆ Të hartëzojnë palët e interesit dhe të paraqesin sferën e tyre të fuqisë,
 - ◆ Të tregojnë pozicionin e tyre si organizatë për të drejtat e njeriut.

♦ **Kërkoni nga dy grupet që merren me rastin e parë studimor të paraqesin punën e tyre me një përfaqësues. Inkurajoni diskutimin në radhët e fëmijëve duke ngritur këto pyetje:**

- ♦ A është interpretuar situata ngjashëm në të njëjtën mënyrë nga dy grupet? Nëse jo, pse?
- ♦ A keni patur ndonjë vështirësi gjatë punës tuaj? Nëse po, çfarë vështirësish?
- ♦ A janë përfshirë në hartë të gjithë palët e interesit? Nëse jo, kush është harruar?
- ♦ A është i duhur pozicioni i grupeve?

Përsëriteni të njëjtën procedurë me të dyja grupet që merren me rastin e dytë studimor.

♦ **Kërkoni nga fëmijët të punojnë në grupe për të hartuar një strategji dhe vini në dukje veprimet e mundshme që mund të çojnë drejt zgjidhjes së drejtë të çështjes. Për ta lehtësuar punën e tyre, kërkoni nga fëmijët t'u përgjigjen pyetjeve në vijim:**

- ♦ Çfarë mund të bëjmë?
- ♦ Si mund ta bëjmë?
- ♦ Kush do të jetë në qendër të veprimit tonë?
- ♦ Kush mund të na ndihmojë në këtë veprim?
- ♦ A ka pengesa në këtë proces?

♦ **Kërkoni nga dy grupet që merren me rastin e dytë që të prezantojnë planet e tyre. Inkurajoni diskutimin në radhët e fëmijëve duke bërë këto pyetje:**

- ♦ A janë të ngjashme apo të përafërta veprimet e dy grupeve? Ku dallojnë?
- ♦ A ia kanë dalë të identifikojnë si duhet aleatët dhe kundërshtarët e mundshëm?
- ♦ Po rrezikët, a janë paraparë? A ka ndonjë rrezik tjetër që mund ta vërë në pikëpyetje këtë veprim?

Përsëriteni të njëjtën procedurë me të dyja grupet që merren me rastin e parë.

Përmbledhje

Përmbliidheni aktivitetin duke u shpjeguar fëmijëve se aktivizmi për të drejtat e njeriut njihet edhe si avokim. Avokimi përdoret edhe në sfera të tjera dhe para së gjithash ka për qëllim të mbështesë një ide ose kauzë duke iu përkushtuar asaj dhe duke sjellë argumente për atë ide apo kauzë në veçanti. Avokimi kryesisht i drejtohet

vendimmarrësve për t'i bindur ata të marrin vendime që do të mbrojnë interesin e palëve për të cilat avokojmë. Në aspektin e të drejtave të njeriut, avokimi synon respektimin e të drejtave të njeriut dhe të interesave të grupeve të drejtat e të cilëve janë në rrezik.

FLETË PUNE: RASTE STUDIMORE

Rasti 1 – FËMIJË ME NEVOJA TË VEÇANTA

Një organizatë joqeveritare ka hetuar rastet e fëmijëve me nevoja të veçanta dhe ka shkruar një raport. Raporti tregon se tre fëmijë të moshës për shkollë në lagjen tuaj nuk e ndjekin shkollën për shkak të faktit se janë fëmijë me nevoja të veçanta. Administrata e shkollës dhe autoritetet lokale për arsim nuk mund t'u ofrojnë shkollim këtyre fëmijëve për shkak të vështirësive financiare dhe deficiteve infrastrukturore. Aktivitetet e OJQ-së kanë folur me prindërit e fëmijëve me nevoja të veçanta. Prindërit janë të mendimit se fëmijët e tyre, për shkak të kushteve në të cilat gjenden, nuk mund të vijnë shkollën apo të shoqërohen me fëmijë të tjerë.

Kjo çështje ju ka prekur shumë dhe keni vendosur të veproni.

Rasti 2 – DHUNA NË RADHËT E BASHKËMOSHATARËVE

Shkolla juaj njihet se ka ushqyer respekt dhe tolerancë në shkollë. Dëshmi e kësaj është një letër vlerësimi që Ministria e Arsimit i ka dërguar shkollës tre vjet më parë.

Dy vjet më parë, qeveria vendosi që ta zhvendosë fshatin Plis, i cili gjendet pranë fshatit tuaj, pasi planifikohet të ndërtohet një termocentral. Një pjesë e popullsisë së fshatit Plis është vendosur në një lagje pranë shkollës tuaj dhe fëmijët e tyre vijnë shkollimin në shkollën tuaj. Që nga ajo kohë, shkolla punon me dy ndërrime. Komuniteti i shkollës ishte kundër “të rinjve” dhe gjendjes së krijuar pas ardhjes së tyre, por askush nuk i pyeti ata.

Këtë vit shkollor ka patur raste të shpeshta të dhunës në radhët e nxënësve. Disa grupe nxënësish janë identifikuar si grupe rivale. Shumica e fëmijëve në shkollë ndjehen të pasigurtë dhe kjo ka ndikuar në performancën e përgjithshme të shkollës. Rastet e ngacmimit dhe bullizmit i janë raportuar komitetit të shkollës për të drejta të fëmijëve dhe ju keni vendosur të ndërmerrni veprime për ta ndaluar këtë dukuri në shkollë.

Burime shtesë:

QAK, “Arsimi për të drejtat e njeriut me fëmijët.” Prishtinë, 2010.

2

Edukimi për paqe
// **Ndërmjetësimi**

Temat për paqe dhe ndërtim të qëndrueshmërisë (resilience)

- ◆ Parandalimi i dhunës
- ◆ Zgjidhja e problemeve
- ◆ Të dëgjuarit aktiv
- ◆ Të kuptuarit e mendimeve të ndryshme
- ◆ Pajtimi

Rezultatet ndërkurrikulare

- ◆ Dallon faktet nga mendimi
- ◆ Krijon/sjell argument duke përdorur burime të ndryshme
- ◆ I kontribuon punës në grup në mënyrë konstruktive
- ◆ Respekton mendimet e të tjerëve



Burimet kryesore

Doracaku i plotë për Ndërmjetësimin në Shkolla mund të gjendet në shqip, anglisht dhe serbisht:

SH: http://www.dwp-balkan.org/cms_dwp/userfiles/file/TRAINING%20MATERIALS_alb.pdf

AN: http://www.dwp-balkan.org/cms_dwp/userfiles/file/TRAINING%20MATERIALS_eng.pdf

SR: http://www.dwp-balkan.org/cms_dwp/userfiles/file/TRAINING%20MATERIALS_bhs.pdf

Lidhjet me Kurrikulën Bërthamë

Fushat e kurrikulës dhe shkalla kryesore	Aktivitetet	Rezultatët e të nxënit për secilën fushë	Rezultatet e të nxënit për kompetenca
Shoqëria dhe mjedisi, (historia, edukata qytetare) Shkalla 3	Nxënësit vlerësojnë deklaratat për të vlerësuar nëse janë fakte apo mendime	Jep ide dhe propozime si dhe merr vendime në mënyrë të vetëdijshme dhe të përgjegjshme 4.1 Vlerëson ndikimin e vendimmarrjes individuale, grupore e institucionale në kohë dhe vende të ndryshme, krijon qëndrime personale për to dhe i përdor në jetën e tij të përditshme.	Komunikues efektiv 1.8 Shpreh drejt mendimin apo kërkesën, me gojë ose me shkrim, në gjuhën joamtare ose të huaj, për një situatë të caktuar të supozuar, në rast nevojë (për shërbim, ndihmë, informim, orientim etj.), duke ndërvepruar në grup ose në klasë.

		<p>4.2 Tregon kujdes, respekt e përgjegjshmëri për vendimmarrjen e drejtë në aktivitetet ku është i përfshirë (në shkollë, bashkësi dhe më gjerë).</p> <p>Përdor në mënyrë efektive Teknologjinë e Informimit dhe Komunikimit dhe teknologjitë e tjera bashkëkohore</p> <p>6.1 Përzgjedh dhe përdor lloje të ndryshme të burimeve digjitale që kanë të bëjnë me raportet shoqërore dhe dukuritë natyrore e mjedisore.</p>	<p>Mendimtar kreativ dhe kritik</p> <p>2.5 Përzgjedh dhe demonstroi ecuri/strategji të ndryshme për zgjidhjen e një problemi (matematik, gjuhësor, shkencor, artistik a shoqëror) duke dëshmuar arritjen e përfundimit, gjegjësisht rezultatin e njëjtë.</p> <p>Nxënës i suksesshëm</p> <p>3.7 I parashtron pyetje vetes (pse, çka, si, kur?) dhe organizon mendimet e veta në formë të shkruar për temën apo problemin e dhënë dhe vlerëson përparimin e vet derisa të gjejë zgjidhjen e duhur për problemin e caktuar.</p>
<p>Shoqëria dhe mjedisi, (historia, edukata qytetare) Shkalla 4</p>	<p>Nxënësit hulumtojnë faktet dhe mendimet nga një periudhë e caktuar kohore ose ngjarje për të eksploruar më tej ngjarje aktuale ose historike</p>	<p>Njeh rolin e individit, strukturën e grupeve shoqërore, mënyrat e pjesëmarrjes dhe përfshirjes në to</p> <p>1.2 Dallon faktet nga opinionet, figurat reale nga ato mitike e legjendare, gjatë interpretimit të situatave të ndryshme në marrëdhëniet midis individëve apo të grupeve shoqërore (në kohë dhe hapësirë).</p>	<p>Individ i shëndoshë</p> <p>5.5 Identifikon shenjat e rrezikut në prodhime apo objekte konkrete dhe u shpjegon të tjerëve porositë apo kërkesën e tyre vizuale.</p> <p>5.6 Vlerëson shkaqet e një situatë të mundshme të konfliktit midis moshatarëve ose midis anëtarëve të grupit dhe propozon alternativa për parandalimin e rrezikut dhe zgjidhjen më të mirë për ta, duke ndarë përvojat dhe mendimet për kohezionin e grupi.</p> <p>5.9 Reagon ndaj sjelljes antisociale të bashkëmoshatarëve të vet duke identifikuar</p>

		<p>Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvarjet dhe ndërveprimet reciproke</p> <p>2.1 Përdor burime të ndryshme kur prezanton dallimet në mënyrën e jetesës së njerëzve në kohë dhe hapësirë, duke pasë parasysh lëvizjet dhe zhvillimet e përgjithshme historike, shoqërore dhe natyrore.</p> <p>Shqyrton në mënyrë kritike dhe zbaton normat dhe rregullat shoqërore për jetë të përbashkët në diversitet</p> <p>3.1 Kupton dhe analizon shkaqet dhe rrethanat e ndryshimit të normave, ligjeve dhe zakoneve për rregullimin e jetës shoqërore në kohëra dhe vende të ndryshme.</p>	<p>shkaqet dhe kur ndodh dhe pasojat e mundshme tek shëndeti dhe mirëqenia e individit për shkak të dukurive dhe zakoneve negative (për shembull, pirja e duhanit, konsumimi i alkoolit ose drogave etj.).</p>
<p>Gjuhët dhe komunikimi, (Gjuha amtare, gjuha angleze, gjuha e huaj e dytë) Shkalla 3</p>	<p>Nxënësit hulumtojnë dhe prezantojnë shembujt e vetë të deklaratave subjektive dhe objektive.</p>	<p>Të dëgjuarit dhe të folurit</p> <p>Merr, krahason dhe përmbledh mendimet e të tjerëve (nëpërmjet pyetjeve dhe përgjigjeve) për temat nga materialet e dëgjuara, të shikuara a të prezantuara dhe reflekton për to.</p> <p>Merr pjesë në biseda shoqërore me moshatarët dhe me të rriturit mbi tema</p>	<p>Komunikues efektiv</p> <p>3.2 Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.</p> <p>3.4 Shpreh mendimin /gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në formë të tjera të komunikimit.</p>

	të njohura duke pyetur dhe duke iu përgjigjur pyetjeve.	3.6 Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe të saktë.
	Debaton dhe argumenton për tema të ndryshme	

Burimet

Materialet e titulluara “Vëzhgim ose vlerësim”

Sfondi

Ndërmjetësimi në shkollë është praktikë e ndërmjetësimit ndërmjet bashkëmoshatarëve brenda kontekstit shkollor (për këtë arsye, ai gjithashtu mund të quhet "ndërmjetësim nga bashkëmoshatarët"). Qëllimi i ndërmjetësimit në shkollë është zgjidhja jo e dhunshme dhe e qëndrueshme e konflikteve. Është proces vullnetar, me hapa dhe praktika të përcaktuara, që udhëzon një palë të tretë të paanshme, ndërmjetësin, në veprimet e tij/saj. Në kontekstin shkollor, nxënësit dhe mësime ndërmjetësimi mund të veprojnë si ndërmjetësues për të zgjidhur konfliktet midis nxënësve, por edhe ndërmjet tyre dhe mësime ndërmjetësimi, drejtorëve dhe prindërve. Për më tepër, përtej të qenit një proces teknik, ndërmjetësimi gjithashtu promovon një frymë pozitive bazuar në vlerat e veta thelbësore. Si rezultat, efekti i ndërmjetësimit shpesh shkon përtej zgjidhjes së konflikteve. Brenda kontekstit shkollor, raportohet rregullisht që atmosfera e një shkolle ndryshon pozitivisht pasi të futet ndërmjetësimi: drejt një fryme më bashkëpunuese dhe optimiste, duke i fuqizuar nxënësit, mësime ndërmjetësimi dhe prindërit të ndiejnë përgjegjësi për shkollën në tërësi. Përveç udhëzimit të prezantimit të ndërmjetësimit

brenda kontekstit shkollor, Doracaku për Ndërmjetësimin në Shkollë mund të jetë me rëndësi për të trajtuar çështje që lidhen me konfliktin dhe transformimin e konflikteve dhe të prezantojë metoda alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve gjatë orëve të rregullta mësimore, duke i ndërlidhur ato me Kornizën e Kurrikulës. Përmbajtja e paraqitur mund të ndahet në mësim të ndryshme, duke u marrë me tema specifike në secilin mësim (si psh: kuptimi i llojeve të ndryshme të komunikimit, të kuptuarit e vlerave të ndërmjetësimit, dallimi i fakteve nga opinionet, etj)

Më konkretisht, përmes aktiviteteve të propozuara më poshtë, nxënësit mësojnë se si të dallojnë faktet nga opinionet, dhe vëzhgimin objektiv nga vlerësimi subjektiv. Në këtë mënyrë, nxënësit kuptojnë se gjithmonë ekzistojnë këndvështrime të ndryshme për një fakt të vetëm: edhe në rast mosmarrëveshjeje, të gjitha duhet të merren parasysh dhe të respektohen si mendime personale ose interpretime të asaj që ndodh (ose ka ndodhur). Për më tepër, duke punuar së bashku në grupe, nxënësit forcojnë aftësitë e tyre të komunikimit, punës ekipore dhe zgjidhjes së problemeve.

Vëzhgim apo vlerësim?

Vendosni se cilat nga deklaratat më poshtë janë “fakte” dhe cilat janë “opinione” dhe pse.

- ◆ “Xhoni u zemërua me mua dje pa arsye.”
- ◆ “Dje në mbrëmje Nensi kafshoi thonjtë ndërsa shihte televizorin.”
- ◆ “Semi nuk më pyeti për mendimin tim gjatë takimit.”
- ◆ “Babai im është burrë i mirë.”
- ◆ “Xhenisa punon shumë.”
- ◆ “Henri është agresiv.”
- ◆ “Pemi ishte e para në radhë çdo ditë këtë javë.”
- ◆ “Djali im shpesh nuk i lan dhëmbët.”
- ◆ “Luka më tha se ngjyra e verdhë nuk më rri mirë.”
- ◆ “Tezja ime ankohet kur flas me të.”

Udhëzime:

HAPI 1

Mësimdhënësi i ndan nxënësit në grupe të vogla (mundësisht me 3 deri 5 anëtarë) dhe shpërndan nga një kopje të materialit “Vëzhgimi ose vlerësimi” tek secili grup. Duke punuar së bashku, nxënësit vlerësojnë deklaratat e dhëna dhe vlerësojnë nëse janë fakte apo opinione. Pas 15-20 minutash pune në grup, mësimdhënësi e përfshin të gjithë klasën në diskutim: për çdo fjali, grupet japin përgjigjet e tyre dhe mësimdhënësi komenton.

“Fakti” ka të bëjë me “vëzhgim” objektiv, pa “vlerësim”. Në rast se fjalia përfshin “opinionin” personal të folësit ose të një aktori tjetër (qartësisht ose në mënyrë të nënkuptuar), atëherë ai shpreh “vlerësim”.

HAPI 2

Sapo ndryshimi midis “fakteve” dhe “opinioneve” (pra edhe ndërmjet “vëzhgimit” dhe “vlerësimit”) është i qartë për nxënësit, mësimdhënësi identifikon një ngjarje aktuale ose historike dhe u kërkon nxënësve të hulumtojnë fakte dhe opinione rreth asaj ngjarjeje.

Sa i përket Hapit 1, rekomandohet të krijoni grupe të vogla me nxënës dhe secilit grup t’i siguroni materialin e shtypur në lidhje me temën/ngjarjen e zgjedhur (artikuj gazetash, libra shkollorë). Përndryshe, nxënësit mund të përdorin burime të internetit për të gjetur materiale shtesë.

HAPI 3

Nxënësit hulumtojnë dhe paraqesin shembujt e tyre të deklaratave subjektive dhe objektive në lidhje me një ngjarje që ndodh në shkollën ose klasën e tyre.

Shembuj: një diskutim/mosmarrëveshje në lidhje me destinacionin e udhëtimit të shkollës; një konflikt midis dy nxënësve gjatë një detyre në grup; një konflikt midis një djali dhe një vajze në lidhje me pjesëmarrjen e saj në një lojë futbollit gjatë orëve të edukatës fizike; një diskutim midis një mësimdhënësi dhe një nxënësi në lidhje me vonesën e nxënësit pas pushimit.

Përmes kësaj, nxënësit kuptojnë rëndësinë e dallimit të fakteve nga opinionet në situata konkrete të jetës së përditshme.

2

Edukimi për paqe

// **Pranimi dhe gjithëpërfshirja**

Temat për paqe dhe ndërtim të qëndrueshmërisë (resilience)

- ◆ Zgjidhja e problemeve
- ◆ Të dëgjuarit aktiv
- ◆ Të kuptuarit e mendimeve të ndryshme
- ◆ Puna ekipore
- ◆ Komunikimi i sqartë
- ◆ Roli i nxënësve në ndërtimin e paqes

Rezultatet ndërkurrikulare

- ◆ Identifikon dhe analizon shembuj nga bota reale të stereotipeve, diskriminimit, pranimit dhe gjithëpërfshirjes.
- ◆ Shpreh dhe diskuton këto koncepte në një shumëllojshmëri të mjediseve bashkë me moshatarët dhe të rriturit.
- ◆ Shpjegon rëndësinë e bashkëpunimit me të tjerët për të bërë aktivitete të përbashkëta.
- ◆ Demonstron rëndësinë e marrjes së përgjegjësisë individuale për t'i kontribuar të gjitha niveleve të shoqërisë.



BURIMI

Play International-
- Paketa lojë-
pedagogji
"Trajtimi i
stereotipeve
dhe diskriminimi,
kultivimi i
pranimit dhe
gjithëpërfshirjes."

Lidhjet me Kurrikulën Bërthamë

Fushat e kurrikulës dhe faza kryesore	Aktivitetet	Rezultatet e të nxënit për secilën fushë	Rezultatet e të nxënit për kompetenca
Gjuha dhe komunikimi, (Gjuha amtare, gjuha angleze, gjuha e dytë e huaj) Shkalla 3	- Nxënësit bëjnë aktivitete fizike për të simuluar situata shoqërore dhe për të diskutuar konkretisht koncepte dhe terminologji që kanë të bëjnë me diverzitetin.	Të dëgjuarit dhe të folurit - Merr, krahason dhe përmbledh mendimet e të tjerëve (nëpërmjet pyetjeve dhe përgjigjeve) për temat nga materialet e dëgjuara, të shikuara a të prezantuar dhe reflekton për to. - Debaton dhe argumenton për tema të ndryshme. Të lexuarit - Pasuron fjalorin.	Komunikues efektiv 1.2 Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve. 1.4 Shpreh mendimin/ gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në forma të tjera të komunikimit.

			<p>1.6 Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe të saktë.</p>
<p>Edukata fizike, sportet dhe shëndeti (Edukata fizike, sportet dhe shëndeti), Shkalla 3</p>	<p>Nxënësit ndahen në ekipe dhe kryejnë aktivitete fizike si pikë fillestare për të mësuar se si sjellja e tyre mund të ketë ndikim pozitiv në largimin (e paragjykimeve dhe stereotipeve).</p>	<p>Mirëqenia e plotë fizike, psikike, emocionale dhe sociale 1.1 Shpjegon dhe analizon veprime konkrete për ruajtjen e mirëqenies fizike, psikike, emocionale dhe sociale të tij/saj dhe të tjerëve (në familje, me koleget dhe anëtarët e komunitetit) në situata të ndryshme.</p> <p>Zhvillimi i gjithanshëm dhe harmonik i trupit përmes aktiviteteve fizike 2.1 Demonstron shkathtësi gjatë ushtrimit të teknikave në disiplina sportive (atletikë, gjimnastikë, sportet luftarake etj.) duke përfunduar aftësitë psikologjike individuale dhe kolektive me lëvizjet dhe duke përfshirë kombinime të formave të ndryshme të veprimit.</p> <p>2.2 Dëgjon dhe përshkruan rregullat elementare të sporteve të ndryshme kolektive dhe demonstroi shkathtësi gjatë ushtrimit të elementeve teknike në sportet</p>	<p>Kontribues produktiv 4.7 Ndërvepron aktivisht me bashkëmoshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit shoqëror, etnik etj) për të bërë aktivitete të përbashkëta (projekt/aktivitet në klasë/shkollë ose jashtë).</p> <p>Individi shëndoshë 5.4 Zhvillon aktivitete fizike dhe sportive me karakter rekreativ apo garues, duke bërë përpjekje për arritjen e standardeve të caktuara, me angazhim dhe sjellje të pëlqyera, por edhe duke menaxhuar emocionet e veta gjatë paraqitjes së rezultateve.</p> <p>5.6 Analizon shkaqet e një reagimi konfliktuoz apo emocional nxënës-nxënës dhe propozon alternativa për zgjidhje të drejtë e pa pasoja, duke ndarë përvojat, mendimet dhe ndjenjat me anëtarët e grupit.</p>

Jeta dhe puna,
(Teknologjia dhe TI)
Shkalla 4

Nxënësit marrin pjesë në aktivitete fizike që ndihmojnë në ndërtimin e shkathtësive të komunikimit dhe bashkëpunimit.

Ushtrimi i punës praktike në shtëpi, në shkollë dhe në komunitet

1.2 Planifikon, organizon dhe merr pjesë në aktivitetet praktike individuale dhe në grup.

Promovimi i kushteve të sigurta për jetë dhe punë

6.1 Identifikon dhe parandalon rreziqet e ndryshme të cilat mund të ndodhin në vendin ku punon.

Zhvillimi shoqëror, ekonomik dhe mjedisi.

9.1 Zhvillon aktivitete për çështjet e drejtësisë sociale, etikën dhe mirëqenien, duke lidhur me faktorët socialë, ekonomikë dhe ekologjikë.

Komunikues efektiv

1.5 Prezanton para të tjerëve projekt për temë të caktuar që ai/ajo ka përgatitur vetë apo në bashkëpunim me grupin duke përdorur me forma të komunikimit me gojë dhe elektronik dhe veprime praktike.

Mendimtar kreativ dhe kritik

2.1 Paraqet me gojë ose shkrim në mënyrë grafike ose me simbole argumente të veçanta për të përforuar opinionin e tij/saj apo qëndrimin për ndonjë problem nga disa fusha të caktuara.

Nxënës i suksesshëm

3.7 Përdor me efektivitet teknika të ndryshme gjatë të nxënës të temës duke ndarë informacionin që ai/ajo kupton nga ato që janë të reja, të panjohura dhe informacionin që është ende i paqartë për të.

SHTËPIA E STEREOTIPEVE ME NDËRRIME

Rezultati

Fëmijët të zbulojnë stereotipet ekzistuese.

Mesazhet Kryesore

Stereotip është përdorimi i etiketimeve për të përshkruar të tjerët. Mund të jetë pozitiv ose negativ. Stereotipet janë gjë e gabuar, sepse kështu i gjeneralizojmë njerëzit në kategori në bazë të tipareve apo karakterit. Çdo person është unik. Të gjithë kemi stereotipe për njerëz që nuk i njohim dhe të gjithë mund të jemi objekt i stereotipeve.

15-30 vetë në lojë



8-14 vjeç



10x25 metra



45 minuta



30 kone



3 palë përparëse



Topa ose objekte të tjera



Aneksi për t'u shtypur



Loja pa temë

10

Qëllimi i lojës:

- ◆ Të jesh ekipi që mbledh më së shumti objekte më së shpejti përpara se të mbarojë loja.

Udhëzimet:

- ◆ Ndani fëmijët në 4 grupe. Çdo grup ka pjesën e tyre të fushës. Në mes të fushës është një shtëpi e madhe me shumë sende (topa, fanella, kone, etj).
- ◆ Sa të fishkëllejë bilbili, një lojtar nga secili ekip duhet të vrapojë dhe të marrë një send dhe të kthehet me sendin sërish në zonën e vet.
- ◆ Loja mbaron kur shtëpia zbrazet nga sendet. Pastaj, çdo ekip duhet të numërojë sendet që ka marrë. Fiton ekipi që ka marrë më shumë sende.

Rregullat

- ◆ Lojtarët mund të marrin vetëm një send kur e kanë radhën.
- ◆ Lojtarët duhet të prekin dorën e lojtarit tjetër që të rifillojnë ciklin.
- ◆ Nëse lojtari nuk respekton rregullin e “një send për lojtar” i gjithë ekipi humbet një send i cili kthehet sërish në shtëpinë në mes.

Variacionet

Që ta vështirësoni lojën, mund të vendosni kone rreth shtëpisë dhe secilës zonë. Kështu, çdo lojtar duhet të kalojë zig-zag rreth koneve që të mbërrijë tek shtëpia.

Lojë tematike

20



♦ RREGULLA DHE UDHËZIME

Përdor fjalorin e ri për të përshkruar lojën

Loja tematike ndahet në dy faza:

Faza 1. Zonat e ekipeve afrojnë më shumë me shtëpinë.

Secili ekip simbolizon një grup. **1) Persona me aftësi të kufizuara, 2) Të varfër, 3) Evropianë, 4) Njerëz nga fshati.** Këto grupe shenjohen me një letër që ngjitet mbi një kon për t'iu ndihmuar anëtarëve që t'i mbajnë mend (Shtojca 1). Tani në shtëpi ka stereotipe të përziera për këto grupe të ndryshme (Shtojca 2).

Detyra e lojtarëve është të vrapojnë në shtëpi, të marrin një stereotip, të kthehen tek ekipi dhe të **vendosin bashkërisht** në cilën zonë grupe hyn më shumë. Lojtari e sjell kartën në atë zonë grupe dhe kthehet në grup për ta caktuar lojtarin tjetër që të shkojë. Mësimdhënësi e mbikëqyr lojën nga pranë shtëpisë dhe ndihmon nëse është nevoja.

Kur shtëpia të zbrazet, ekipet bëhen bashkë për disa minuta dhe zgjedhin 3 stereotipe që sipas tyre kanë të bëjnë me grupin. Para se të kaloni në fazën tjetër duhet të zhvillohet një debat i shkurtër: **nga secili ekip 3 pjesëtarë prezantojnë se cilat stereotipe kanë zgjedhur dhe pse. Fëmijët mundën edhe të shtojnë stereotipe që kanë në mendje, por që nuk janë përfshirë në kartat e tyre.**

Faza 2. Secili ekip simbolizon një komunitet të Kosovës. **1) Romë, 2) Serbë, 3) Shqiptarë, 4) Boshnjakë.** Këto grupe shenjohen me një letër që ngjitet mbi një kon për t'iu ndihmuar anëtarëve që t'i mbajnë mend (Shtojca 3). Tani në shtëpi ka stereotipe të përziera (Shtojca 4) për këto grupe të ndryshme.

Detyra e lojtarëve është të vrapojnë në shtëpi, të marrin një stereotip, të kthehen tek ekipi dhe të vendosin bashkërisht në cilën zonë grupe hyn më shumë. Lojtari e sjell kartën në atë zonë grupe dhe kthehet në grup për ta caktuar lojtarin tjetër që të shkojë. Mësimdhënësi e mbikëqyr lojën nga pranë shtëpisë dhe ndihmon nëse është nevoja.

Kur shtëpia të zbrazet, ekipet bëhen bashkë për disa minuta dhe zgjedhin 3 stereotipe që sipas tyre kanë të bëjnë me grupin. Para se të kaloni në fazën tjetër duhet të zhvillohet një debat i shkurtër: **nga secili ekip 3 pjesëtarë prezantojnë se cilat stereotipe kanë zgjedhur dhe pse. Fëmijët mundën edhe të shtojnë stereotipe që kanë në mendje, por që nuk janë përfshirë në kartat e tyre.**

Diskutim

Pyetje

A ju pëlqyen lojërat?

Në jetën reale, a i etiketojmë njëjtë këta njerëz? Pse? **A ju kanë etiketuar ndonjëherë për shkak të komunitetit tuaj? Si ju ka bërë të ndjeheni?**

Çfarë është stereotipi? Ku bazohen stereotipet? A janë stereotipet gjithnjë negative?

A është e gabuar të kesh stereotipe? Cilat mund të jenë pasojat e stereotipeve?

Pikat kryesore

15 

Në jetën reale, të gjithë etiketojmë njerëz dhe bëhemi objekt i etiketimit. Në e bëjmë këtë, sepse e bën më të lehtë të kuptojmë një botë komplekse. Mirëpo, ne bëjmë supozime për grupe që nuk i njohim. Në Kosovë, shpesh i etiketojmë njerëz se i përkasin një komuniteti të ndryshëm dhe kjo mund të na pengojë të jemi në kontakt me ta.

Stereotipi është përdorimi i etiketimeve për të përshkruar të tjerët. Shpesh, këto etiketime mund të mbështeten mbi karakteristika si veshja, pamja, mënyra si flet një person, apo grupi të cilit i takon ai ose ajo. Ne mund ta gjykojmë një grup të tërë bazuar mbi një person ose një përvojë. Stereotipi mund të jetë edhe pozitiv, edhe neutral. Në lojë patëm stereotipe pozitive si “të gjithë evropianët janë të pasur” dhe “të gjithë serbët janë të gjatë”.

Stereotipizimi jo vetëm që lëndon, por është edhe i gabuar. Nëse vazhdimisht e poshtëron dikë për shkak të karakteristikave të grupit të cilit ai/ajo i takon nuk e inkurajon personin të ketë sukses. Nuk mund t'i përgjithësojmë njerëzit nëpër kategori në bazë të tipareve apo të karakterit. Secili person është unik. Stereotipizimi mund të çojë në diskriminim që përngjan me bullizmin.

Nuk ju pëlqejnë sportet	Askush nuk i do	Janë të pasur	Punojnë në fusha
Gjithnjë kanë nevojë për ndihmë	Ju pëlqen të jenë të papastër	Jetojnë në vende të bukura	Nuk ikin kurrë nga fshati
Janë njerëz të mirë	Të gjithë i shmangin	Punojnë shumë	Nuk shkojnë në shkollë
Ata vuajnë	Nuk kanë shkollim	Mendojnë se janë më të mirë	Janë të fortë
Nuk mund të bëjnë gjithçka	Kanë marrë vendime të këqija në jetë	I respektojnë rregullat	Veshin rroba të tmerrshme
Janë të pafajshëm	Nuk punojnë	Janë më të mirë në sporte	Flasin vetëm me dialekt

Shtojca 2 -
Persona
me aftësi të kufizuara
Shtëpia e Stereotipeve
Për Lojën 1, Faza 1

Të varfërit

Evropianët

Fshatarët

Të varfërit

Fshatarët

Persona me
aftësi të kufizuara

Evropianët

Nuk flasin shqip	Kërkojnë lëmshë	Janë të dhunshëm	Ju pëlqen të dëgjojnë këngët e Dua Lipës
Janë miq me serbët	Nuk shkojnë në shkollë	Të gjithë i urrejnë shqiptarët	Janë më të mirët në futboll
Nuk janë të zgjuar	Nuk duan të punojnë	Janë shumë të mirë në basketboll	Të gjithë i urrejnë serbët
Kanë ushqim të mirë	Kurrë nuk i respektojnë rregullat	Nuk duan të luajnë me shqiptarët	Kanë familje të mëdha
Të gjithë janë myslimanë	Punojnë si pastrues rrugësh	Janë të gjatë	Janë miqësorë
Mbështesin vetëm ekipin futbollit nga Bosnja	Bëjnë muzikë të mirë	Janë të rrezikshëm	Vendimet i marrin burrat
Boshnjakët	Romët	Serbët	Shqiptarët Për Lojën 1, Faza 1

Shtojca 4 -
Shtëpia e
Stereotipeve,
Për Lojën 1, Faza 1

Shqiptarët

Serbët

Boshnjakët

Romët

Prapavija

PLAY International është OJQ franceze e themeluar në vitin 1999 e pranishme në Kosovë që nga përfundimi i luftës. Regjistruar në vend që nga viti 2002, OJQ-ja është veçanërisht aktive me djem dhe vajza të reja nga komunitete të ndryshme dhe kontribuon në krijimin dhe forcimin e një shoqërie më gjithëpërfshirëse. Duke përdorur aktivitete sportive bashkëpunuese dhe edukative, PLAY International Kosova përqendrohet në fuqizimin e fëmijëve dhe të rinjve nga komunitete dhe prejardhje të ndryshme për t'i bërë ata aktorë të ndryshimit shoqëror. Përmes programeve tona, të rinjtë fitojnë vetëbesim, zhvillojnë aftësi për jetën, si dhe marrin pjesë në luftimin e stereotipeve, diskriminimit dhe përjashtimit.

Playdagogy është metodologji inovative e arsimit aktiv, specifike nga PLAY International. Kjo metodologji përdor sportin si mjet edukativ, por edhe si katalizator për eksperimente shqisore, konjitive dhe emocionale. Kjo dinamikë ndihmon

fëmijët dhe të rinjtë të reflektojnë dhe të ndajnë diskutime për çështje sociale ose mjedisore.

Çdo sesion i Playdagogy zgjat rreth 45-60 minuta dhe ndahet në tre hapa:

1. LOJA PA TEMATIKË: një sesion i zakonshëm bazohet tek aktivitetet fizike (hendboll, basketboll, etj.) ose lojëra tradicionale të mirënjohura (macja dhe miu, të preka, etj.). fëmijët luajnë dhe kënaqen duke praktikuar aktivitet fizik.

2. LOJA ME TEMATIKË: fjalori dhe simbolet përfshihen në lojë për t'i familjarizuar fëmijët me temën e trajtuar. Kjo gjë krijon lidhje ndërmjet lojës dhe jetës së përditshme.

3. DEBATI: në përfundim të sesionit, mbahet një diskutim për t'iu dhënë fëmijëve mundësinë që të reflektojnë dhe shprehën për tematikën e rritjes së vetëdijësimit. Mesazhet kryesore përcillen dhe diskutohen.

Lexime të tjera dhe burime shtesë

Paketa Playdagogy: 'Trajtimi i stereotipeve dhe diskriminimit, kultivimi i pranimit dhe gjithëpërfshirjes' përbëhet nga 2 cikle me nga 3 lojëra secila. Cikli i parë fokusohet tek eksplorimi i disa koncepteve *negative* që kanë të bëjnë me diversitetin (stereotipe, diskriminim dhe përjashtim). Cikli i dytë fokusohet tek aspektet *pozitive* të diversitetit dhe tek evoluimi nga pranimi në gjithëpërfshirje. Për më shumë hollësi

rreth lojërave, ju lutemi shikoni tabelën më poshtë.

Doracaku që shpjegon metodologjinë me hollësi dhe që jep këshilla praktike është në dispozicion **të mësimeve** që të fasilitojnë implementimin e sesioneve. Kontaktoni me PLAY International që të kërkonit lojëra të tjera të paketës dhe doracakun.

CIKLI	EMRI	TEMA	REZULTATI	MESAZHET KRYESORE
1	Shtëpia e Stereotipeve	Zbulo stereotipin tënd	Për të kuptuar se stereotipet janë gjithnjë të këqija dhe nuk është e mundur të identifikohet një grup nën një përkufizim.	<ul style="list-style-type: none"> • Stereotipi është përdorimi i etiketimeve për të përshkruar të tjerët. Mund të jetë pozitiv ose negativ. • Të bësh stereotipe është e gabuar, sepse nuk mund t'i përgjithësojmë njerëzit nëpër kategori në bazë të tipareve apo karaktereve. Çdo person është unik. • Të gjithë kemi stereotipe për njerëzit që nuk i njohim dhe të gjithë mund të jemi objekt i stereotipeve.
1	Nën diskriminim	Të kuptosh diskriminimin	Të kuptosh se diskriminimi është pasojë e stereotipeve dhe çon në përjashtim.	<ul style="list-style-type: none"> • Stereotipizimi i njerëzve ndikon tek sjellja jonë ndaj tyre. • Diskriminim do të thotë t'i trajtosh njerëzit në mënyrë të padrejtë, për shkak të karakteristikave të tyre si gjinia ose etnia. • Diskriminimi negativ mund të çojë në përjashtim social nga një grup dhe mund të jetë shumë lëndues për personin që e përjeton.
1	Zinxhiri i Kosovës	Komunitetet dhe stereotipet	Të kuptosh stereotipet e ndryshme që mund të kemi për komunitetet në Kosovë dhe lufta kundër diskriminimit të pranishëm.	<ul style="list-style-type: none"> • Kosova është shoqëri diverse me shumë komunitete të ndryshme. • Ekzistojnë stereotipe për secilin komunitet që jeton në Kosovë dhe të gjithë vuajnë nga diskriminimi. • Mund të luftojmë kundër stereotipeve duke njohur njëri-tjetrin: nuk duhet të kemi frikë nga të tjerët sepse duken, flasin apo sillen ndryshe nga ne. • Nuk duhet t'i përjashtojmë njerëzit në bazë të dallimeve që kanë, sepse ky është diskriminim.

CIKLI	EMRI	TEMA	REZULTATI	MESAZHET KRYESORE
2	Pyetje dhe befasi	Tejkaloji stereotipet e tua	Te kuptosh se është e mundur t'i tejkalojmë stereotipet vetëm duke njohur veten	<ul style="list-style-type: none"> Nëse duam të luftojmë diskriminimin, duhet të njohim dhe kuptojmë stereotipet tona . Për të kuptuar stereotipet tona duhet të dimë se nga vijnë. Për të tejkalar stereotipet tona duhet të njohim veten, ndjenjat dhe mendimet tona dhe të jemi të gatshëm t'i vëmë në pikëpyetje .
2	Diversiteti është pasuri	Diversiteti është pasuri	Të kuptosh se shkëmbimet me të tjerët pasurojnë të dyja palët	<ul style="list-style-type: none"> Të gjithë jemi të ndryshëm si individë, pra kemi nevojë të pranojmë dhe respektojmë dallimet. Mund t'i tejkalojmë stereotipet duke u takuar, patur shkëmbime, duke qenë të hapur dhe kureshtarë për të tjerët, duke luajtur bashkë. Duke u takuar, mund të mësojmë nga të tjerët dhe të tjerët nga ne: diversiteti të pasuron.
2	Të gjitha bashkë	Nga pranimi në gjithëpërfshirje	Të kuptosh se të përfshish dikë do të thotë të bësh gjëra bashkë, të kesh të njëjtat mundësi dhe të ndjehesh i barabartë.	<ul style="list-style-type: none"> Të jesh i pranuar/pranues për të tjerët nuk mjafton: të jesh i integruar do të thotë të bësh gjëra bashkë, të kesh të njëjtat mundësi, të ndjehesh i barabartë. “Të jetosh dhe veprosh bashkërisht” mund të jetë sfiduese kudo në botë. Secili nga ne është i rëndësishëm për të ndërtuar shoqëri gjithëpërfshirëse.

2

Edukimi për Media
// **Siguria në Media Sociale**

Temat për paqe dhe ndërtim të qëndrueshmërisë (resilience)

- ◆ Reklamimi dhe ndikimi i tij
- ◆ Shkathtësi për informacion dhe biblioteka
- ◆ Përdorimi etik i informacionit
- ◆ Roli i medias në nxënie, dialog ndërkulturor, shoqëri demokratike
- ◆ Mbledhja dhe prezantimi i të dhënave
- ◆ Media sociale: reputacioni dhe bullizmi kibernetik

Rezultatet ndërkurrikulare

- ◆ Analizon dhe krahason burimet nga rrjetet sociale (Instagram, Snapchat etj.) për tema të ndryshme
- ◆ Identifikon persona/palë/grupe interesi dhe me kë ai/ajo dëshiron të komunikojë
- ◆ Implementon metoda të sigurisë në Snapchat dhe Instagram, si bllokimi i personave të tjerë, hashtag, etj.



Burime kryesore

https://kosovo.savethechildren.net/sites/kosovo.savethechildren.net/files/library/Udhëzuesi-per-femije_FIT%20%281%29.pdf

Lidhjet me Kurrikulën Bërthamë

Fushat e kurrikulës dhe faza kryesore	Aktivitetet	Rezultatet e të nxënit për secilën fushë	Rezultatet e të nxënit për kompetenca
Gjuhët dhe komunikimi, Shkalla 3	Mësimdhënësi të fasiltojnë analizën e rolit pozitiv dhe negative të medias sociale përmes punës individuale dhe në grup, kuizeve, lojës me role, etj.	Të dëgjuarit dhe të folurit Merr, krahason dhe përmbledh mendimet e të tjerëve (nëpërmjet pyetjeve dhe përgjigjeve) për temat nga materialet e dëgjura, të shikuara a të prezantuara dhe reflekton për to.	Komunikues efektiv 1.3 Veçon porosinë kryesore të lexuar ose të dëgjuar nga një burim, si libër, gazetë, revistë, internet, radio TV etj., e komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë hartimit të një punimi/detyre me shkrim.

		<p>Debaton dhe argumenton për tema të ndryshme.</p> <p>Të shkruarit Përdor materiale të ndryshme për të këmbyer porosi, nëpërmjet reklamave, shpalljeve, lajmërimeve dhe bën prezantimin e tyre në medie.</p>	<p>1.7 Përdor programet softuerike për komunikim në distancë në forma të caktuara të komunikimit, qoftë për nevoja të veta në jetën e përditshme apo si detyrë shkollore.</p> <p>Mendimtar kreativ dhe kritik 2.1 Paraqet argumente për pajtueshmëri ose kundërshtim të një qëndrimi ose mendimi për një temë/problem të caktuar gjatë një debati ose të publikuar në medie.</p>
<p>Gjuhët dhe komunikimi, Shkalla 4</p>	<p>Diskuton me shokët e tij/saj të klasës përkufizimin e "Dhunës digjitale".</p>	<p>Të dëgjuarit dhe të folurit Bisedon me moshatarët dhe me të rriturit për tema të panjohura dhe për situata komplekse shoqërore.</p> <p>Debaton, analizon dhe argumenton për tema të ndryshme.</p> <p>Të shkruarit Shkruan për tema të caktuara</p>	<p>Komunikues efektiv 1.1 Lexon rrjedhshëm, me intonacion të duhur, një tekst të caktuar rrëfyes, përshkruar, shkencor a publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës me gojë ose me shkrim.</p> <p>1.5 Prezanton para të tjerëve projekt për temë të caktuar që ai/ajo ka përgatitur vetë ose në bashkëpunim me grupin duke përdorur mënyra të komunikimit me gojë, elektronik dhe veprimet shoqërore praktike.</p> <p>1.8 Inicon biseda shoqërore me bashkëmoshtarë dhe të rritur në tema me interes edukativ/shoqëror duke bërë pyetje rreth temës dhe duke u përgjigjur dhe zgjedhur informacionin kryesor.</p>

**Shoqëria
dhe mjedisi,**
Shkalla 3

Bisedon për përvojat e veta personale /sfidat mbi përdorimin e rrjeteve sociale dhe mënyrat për të ruajtur privatësinë.

**Njeh rolin e individit,
strukturën e grupeve
shoqërore, mënyrat e
pjesëmarrjes dhe
përfshirjes në to**

1.1 Njeh grupet dhe institucionet shoqërore, strukturën dhe organizimin e tyre, si dhe ndërlidhjen me kontekstin kohor dhe hapësinor.

**Përdor në mënyrë
efektive Teknologjinë
e Informimit dhe
Komunikimit dhe
teknologjitë e tjera
bashkëkohore**

6.1 Përzgjedh dhe përdor lloje të ndryshme të burimeve digjitale që kanë të bëjnë me raportet shoqërore dhe dukuritë natyrore e mjedisore.

6.2 Përdor teknologjinë adekuate për moshën për të prezantuar idetë e tij para të tjerëve.

Kontribuues produktiv

4.5 Përdor programet kompjuterike për përpunimin e të dhënave dhe paraqitjen e vizatimeve/diagrameve të nevojshme për përgatitjen e materialeve individuale apo/ dhe publikimeve të ndryshme të shkollës.

Individ i shëndoshë

5.6 Analizon shkaqet e një reagimi konfliktuoz apo emocional nxënës-nxënës dhe propozon alternativa për zgjidhje të drejtë e pa pasoja, duke ndarë përvojat, mendimet dhe ndjenjat me anëtarët e grupit.

Qytetar i përgjegjshëm

6.4 Shpreh mirëkuptim ndaj personave që kanë pësuar shkelje të ndonjë prej të drejtave të tyre, duke dhënë ilustrime të shembujve nga jeta e përditshme nga media, të dhëna historike dhe personazhet e romaneve që ai/ajo lexoi ose nga filmat që ai/ajo i ka parë në mënyrë që të parandalojë ato duke u përsëritur përsëri.

Instagram

Çka është Instagram-i ?

Instagram është platformë e rrjeve sociale e cila përdoret për postimin e fotografive dhe videove. Shpërndarja e fotografive dhe videove është shumë atraktive për fëmijët pasi që lejon rregullimin e fotografive me anë të filterëve të ndryshme.

Videot mund të jenë nga 3 deri në 12 sekonda. Rregullat e Instagramit thonë “Duhet të jesh së paku 13 vjeç për të qenë përdorues i Instagramit”.

Profili i Instagram-it

Karakteristikat e mëposhtme janë pjesë e faqes kryesore të Instagramit:

- ◆ Fotografia e profilit – çdokush mund të klikojë në faqen e profilit dhe ta ruaj në telefonin e tij/ saj.
- ◆ Emri dhe Mbiemri – çdokush mund t’ju gjejë në Facebook me anë të emrit dhe mbiemrit tuaj.
- ◆ Çdokush mund t’ju dërgojë mesazh – edhe personat të cilët nuk janë pjesë e Facebook-ut tuaj mund t’ju dërgojnë mesazh.

Opsionet e Privatësisë

Profili i Instagramit mund të jetë publik dhe privat. Nëse Instagrami juaj është privat atëherë:

- ◆ Vetëm ndjekësit tuaj mund të shohin postimet, pëlqimet dhe komentet tuaja
- ◆ Vetëm ndjekësit tuaj mund të pëlqejnë, komentojnë apo të shpërndajnë postimin tuaj
- ◆ Askush nuk mund t’ju ndjekë në Instagram pa pëlqimin tuaj

Për ta bërë atë privat, përzgjedhni opsionin “Private account” duke e shtyrë butonin nga e djathta.


Nëse instagrami juaj është publik atëherë:

- ◆ Çdo person që gjendet në Instagram mund të shikojë profilin tuaj edhe nëse nuk ju ndjekin
- ◆ Çdokush mund të komentojë, pëlqejë apo shpërndajë postimet tuaja
- ◆ Çdokush mund t’ju ndjekë në Instagram pa pëlqimin tuaj.



- ◆ Numri i postimeve që ju ken
- ◆ Ndjekësit
- ◆ Personat të cilët ju ndjekni
- ◆ Emri dhe Mbiemri
- ◆ Biografia
- ◆ Postimet tuaja përfshirë pëlqimet dhe komentet
- ◆ Fotografitë ku ju jeni prezent dhe jeni 'tag'
- ◆ Postimi i fotografive të reja






◆ Përshkrimi i fotografisë

◆ Tag/ Përmend personin në fotografi

◆ Lokacioni

◆ Shpërndarja në rrjete të tjera sociale

◆ Postimi



e filterave në fotografi për të mundësuar përmirësimin e fotografisë.

Postimi në Instagram


Fotografitë ose videot mund të postohen në Instagram. Hapat rreth postimit të një fotografie janë:

- ◆ Përzgjedhja e fotografisë/videos nga telefoni
- ◆ Vendosja e filterëve të Instagramit
- ◆ Vendosja e përshkrimit në fotografi
- ◆ Tag personin në fotografi
- ◆ Lidhja me rrjetet tjera sociale
- ◆ Postet në Instagram mund të shpërndahen në Facebook, Twitter, Tumblr, Flickr, Foursquare, etc.
- ◆ Postimi i fotografisë dhe pastaj ndjekësit e tuaj mund të pëlqejnë, komentojnë ose të shpërndajnë postimin tuaj.

— Eksplorimi i Fotografive

Karakteristikë e Instagramit është gjithashtu 'Exploring Page' e cila përmban fotografi të ndryshme të personave që e mbajnë profilin publik. Një fotografi e cila merr pëlqime dhe komente hyn në 'Exploring Page' ku çdokush

mund t'i shikojë ato fotografi. Gjithashtu, opsioni i 'People' jep mundësi të ndjekësh persona të tjerë në Instagram dhe këto opsione janë vetëm për persona që profili i tyre është publik.



— Hashtag - Thurje

Një karakteristikë tjetër e Instagramit është opsioni i Hashtag/Thurje. Ky opsion përdoret për t'i etiketuar fotografitë në bazë të përmbajtjes. Për shembull, nëse një fotografi është postuar me thurjen #school atëherë të gjitha fotografitë të cilat janë publike të cilat kanë thurjen #school do shfaqen në 'Exploring Page'.

Metodat e sigurisë në Instagram

- ◆ Fëmijët gjithmonë e mbajnë profilin e tyre privat që të mos i lejojnë të panjohurit të kenë qasje në profilet e tyre.
- ◆ Nëse doni të raportoni një profil që poston gjëra të papërshtatshme, këtë mund ta bëni në mënyrë anonime duke ndjekur hapat në vijim:



Raportimi i Fotografisë

Hapi 1: Në fotografi kliko butonin tri pikësh në të djathtë

Hapi 2: Klikoni në 'Report inappropriate'

Hapi 3: Klikoni në njërën nga arsyet pse po e raportoni postimin

- ◆ Nuk më pëlqen kjo fotografi
- ◆ Kjo fotografi është e spam/scam/ mashtrim
- ◆ Kjo fotografi i vë njerëzit në rrezik
- ◆ Kjo fotografi nuk duhet të vendoset në instagram



Blokimi i përdoruesve të Instagramit

Nëse dëshironi të bllokoni dikë në mënyrë që të mos ketë qasje në profilin tuaj, klikoni butonin tri pikësh në të djathtë. 'Block user' dhe 'Yes I am sure'. Në momentin që ju bllokoni dikë, ai person më nuk mund të ketë qasje në profilin tuaj mirëpo ai/ajo mund të shoh pëlqimet dhe komentet që ju bëni tek miqtë e përbashkët.

– Fëmijët dhe Instagrami

Mënyra më e mirë të mbronni fëmijët tuaj në Instagram është ngritja e vetëdijes dhe profili privat. Profili privat mund t'i lejojë fëmijëve mundësinë të zgjedhin kush mund të ketë qasje në postimet e tyre. Nëse profili i tyre është publik atëherë fotografitë mund të shihen nga të gjithë dhe fotografitë e fëmijës tuaj do gjenden edhe në 'Photo Exploring'. Gjithashtu, me anë të përdorimit të thurjeve, nëse postimi është publik, çdokush që është i interesuar në postime për #school do kenë mundësi t'i shohin fotografitë me atë thurje. Rreziku është i shfaqur shkaku i aksesit dhe promovimit nëse profili është publik.

- ◆ Duhet të mendojnë për një fjalëkalim të sigurtë, që do ishte i vështirë për të tjetrët ta gjejnë
- ◆ Duhet të kenë profilin privat në mënyrë që të pengojnë që fotografitë të shikohen nga

personat e tjerë në Instagram, pavarësisht a janë ndjekës apo jo


- ◆ Së bashku me fëmijën tuaj vendosni cila fotografi është e përshtatshme për fotografi të profilit, pasi që këtë fotografi e shohin të gjithë pavarësisht a është profili privat apo publik;
- ◆ Gjithmonë këshilloni fëmijën tuaj të mos pranojnë persona të cilët ata nuk i njohin;
- ◆ Nëse fëmija juaj është nën 13 vjeç dhe ka profil personal të instagramit atëherë ju duhet t'i tregoni se si të mbyllin instagramin duke e informuar se ky është rregull i instagramit;
- ◆ Për më shumë këshilla, informata dhe rregulla të Instagramit ju mund të klikoni në faqen: <https://help.instagram.com/299484113584685>



Snapchat

Rrjeti Social Snapchat është bërë shumë i famshëm shumë shpejt, sidomos tek gjenerata më të reja. Snapchat është platformë e cila mund të instalohet falas dhe përdoret për të shpërndarë fotografi, video, vizatime dhe biseda mes miqve.


Një nga karakteristikat e Snapchat është se të gjitha fotografitë dhe videot e shpërndara zhduken pas 10 sekondash ku ju mundëson përdoruesve të komunikojnë pa pasoja afatgjate.




Mund ta përcaktosh që foto juaj të shihet 1-10 sekonda.

Postimet në Snapchat

Të rinjët e përdorin Snapchat për të ju dërguar miqve të tyre fotografi duke i'u treguar se çfarë po bëjnë, ku janë etj. Fotografitë mund të dërgohen tek personat e caktuar; mirëpo gjithashtu është opsioni 'Story' ku të gjithë miqtë e tu mund të shohin postimin tuaj. Këto fotografi qëndrojnë për 24 orë dhe zhduken.




- ◆ Nëse në ndonjë rast ndiheni të ngacmuar nga një person, ju mund të bllokoni atë duke mos lejuar atë të ju gjejë më në Snapchat
- ◆ Vetëm miqtë tuaj mund t'ju dërgojnë foto apo video
- ◆ Vetëm miqtë tuaj mund të shohin se çka ju postoni



Opsionet e Privatësisë

Në parametrat e Snapchat, mund të bëhen fotografi dhe video private të cilat mund të postohen dhe vetëm miqtë tuaj në Snapchat mund ti shohin.





Rreziqet e Snapchat

Edhe pse Snapchat është platforma e parë e cila nuk ka fotografi, video apo biseda në telefon prap mund të ketë rreziqe. Kur ju dërgoni fotografitë të cilat gjenden aty për maksimumi 10 sekonda, personit të cilit ia dërgoni mund ta ruajë fotografinë duke e bërë screenshot.

Një rrezik tjetër që është shfaqur së fundmi është instalimi i aplikacionit 'SnapSave'.



Snapkidz

Sikurse rrjetet e tjera sociale edhe Snapchat nuk lejon përdorues më të vegjël se 13 vjet. Nëse përdoruesi është ndër moshën 13 vjeçare atëherë Snapchat i drejton ata tek Snapkidz, verzion më i sigurtë për fëmijët. Në Snapkidz, fëmijët mund të bëjnë fotografi, video dhe vizatime të cilat të gjitha ruhen në telefonat e tyre. Ata nuk mund të bëjnë shok/shoqe në Snapkidz ose të dërgojnë fotografi. Kjo nënkupton se fëmijët mund të luajnë me Snapkidz vetëm në telefonat e tyre.

Temat për paqe dhe ndërtim të qëndrueshmërisë (resilience)

- ◆ Qëllimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm (shih Qëllimi 11: Qytetet dhe vendbanimet e njerëzve të bëhen gjithëpërfshirëse, të sigurta dhe të qëndrueshme).

Rezultatet ndërkurrikulare

- ◆ Identifikon rreziqet që mund të kërcënojnë shkollën dhe mjedisin ku jeton.
- ◆ Identifikon dhe vë në zbatim mënyra për të shmangur rreziqet dhe ka njohuri lidhur me hapat që duhen marrë për të planifikuar evakuim në rast të katastrofave/rreziqeve natyrore apo të shkaktuara nga njeriu.
- ◆ Demonstron shkathtësi në leximin e skicave, hartave, shenjave dhe simboleve të orientimit në bashkëpunim me të tjerët gjatë skenarëve të emergjencës.



BURIMET

**1. Doracaku për
mësimdhënës
2. Libër ushtrimesh
për nxënës**

Për grupmoshat: 6-15

Ahmed, Kamal.

“Comprehensive
Reduction of Disaster
Risk and School Safety –
Manual for Teachers”.
Save the Children dhe
Ministria për Arsim,
Shkencë dhe Teknologji.
2015. Prishtinë, Kosovë.

Burimet kryesore

Dokumentet në shqip mund të gjenden këtu:

https://kosovo.savethechildren.net/sites/kosovo.savethechildren.net/files/library/Zvog%C3%ABlimi%20Gjith%C3%ABp%C3%ABrfshir%C3%ABs%20i%20Rrezikut%20nga%20Fatkeq%C3%ABsit%C3%AB%20dhe%20Siguria%20n%C3%AB%20Shkolla_2.pdf

https://kosovo.savethechildren.net/sites/kosovo.savethechildren.net/files/library/Lib%C3%ABr%20Pune%20%28Workbook%29%20-%202009_3.pdf

Lidhjet me Kurrikulën Bërthamë

Fushat e kurrikulës dhe shkalla kryesore	Aktivitetet	Rezultatet e të nxënës për secilën fushë	Rezultatet e të nxënës për kompetenca
Shoqëria dhe mjedisi, Shkalla 3	Nxënësit bëjnë hartën e shkollës dhe familjarizohen me leximin e hartave në mënyrë që të orientohen brenda	Jep ide dhe propozime si dhe merr vendime në mënyrë të vetëdijshme dhe të përgjegjshme 4.1 Vlerëson ndikimin e vendimmarrjes individuale, grupore e institucionale në kohë dhe vende të ndryshme, krijon qëndrime	Komunikues efektiv 1.4 Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në forma të tjera të komunikimit.

	<p>ndërtesës së shkollës dhe në rrethinat e saj.</p>	<p>personale për to dhe i përdor në jetën e tij të përditshme.</p> <p>4.2 Tregon kujdes, respekt e përgjegjshmëri për vendimarrjen e drejtë në aktivitetet ku është i përfshirë (në shkollë, bashkësi dhe më gjerë).</p> <p>Kontribuon në ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit si dhe në zhvillimin e qëndrueshëm</p> <p>5.2 Vlerëson dhe vepron sipas parimeve bazë të zhvillimit të qëndrueshëm.</p>	<p>Mendimtar kreativ dhe kritik</p> <p>2.4 Zgjidh një problem (aritmetik, gjeometrik, gjuhësor, shoqëror, shkencor... etj.) të dhënë në formë tekstuale ose tekstuale e numerike, eksperimentale dhe arsyeton përzgjedhjen e procedurave përkatëse.</p> <p>2.6 Interpreton rregullat e zhvillimit të një procesi natyror apo shoqëror, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë, si: ilustrim, skicë ose me shkrim.</p>
<p>Shoqëria dhe mjedisi, Shkalla 4</p>	<p>Nxënësit hulumtojnë dhe identifikojnë faktorët e rreziqeve mjedisore në komunitetin e tyre lokal dhe identifikojnë çfarë mund të bëjnë në rast të emergjencave.</p>	<p>Kontribuon në ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit si dhe në zhvillimin e qëndrueshëm</p> <p>5.1 Prezanton shembuj se si, si një individ dhe si një anëtar i një grupi, mund të kontribuojë në zhvillimin e qëndrueshëm (ruajtjen e resurseve, riciklimin e materialeve) në harmoni me ruajtjen e mjedisit dhe të biodiversitetit.</p> <p>Përdor në mënyrë efektive Teknologjinë e Informimit dhe Komunikimit dhe teknologjitë e tjera bashkëkohore</p> <p>6.1 Kategorizon dhe përdor lloje të ndryshme të burimeve mediale për të analizuar ngjarje shoqërore e historike si dhe dukuri gjeografike e mjedisore.</p>	<p>Kontribuues produktiv</p> <p>4.3 Analizon pasojat që sjell dëmtimi i mjedisit për jetën e njeriut dhe të biodiversitetit, paraqet në formë të shkruar, apo në ndonjë formë tjetër të shprehurit, mendimin dhe qëndrimin e vet për këtë çështje, por edhe organizon ndonjë aktivitet për mbrojtjen e mjedisit.</p> <p>4.4 Përdor programet kompjuterike për përpunimin e të dhënave dhe paraqitjen e vizatimeve/diagrameve të nevojshme për përgatitjen e materialeve individuale apo/ dhe publikimeve të ndryshme të shkollës.</p>

		<p>6.2 Përdor teknologjinë për prezantime të ndryshme që kanë të bëjnë me çështje shoqërore, historike, natyrore e mjedisore.</p>	<p>Individ i shëndoshë 5.7 U shpjegon moshatarëve, me forma dhe mjete të ndryshme të komunikimit, rëndësinë e identifikimit të personave dhe shërbimeve kompetentë, veç e veç, të nevojshme për mbështetje në situata që konsiderohen potencialisht të rrezikshme për shëndetin fizik dhe mendor.</p>
<p>Shkencat e natyrës, Shkalla 3</p>	<p>Mësimdhënës it udhëheqin nxënësit të eksplorojnë dukuri si tërmetet, përmbytjet dhe rrëshqitjet e dheut.</p> <p>Burime shitesë ose hulumtime mund të plotësojnë planifikimin për reduktimin e rrezikut nga katastrofat për ta përshtatur mësimin me lëndën tuaj.</p>	<p>Shkathësitë hulumtuese në shkenca 1.1 Ofron hipoteza të bazuara në një numër vëzhgimesh dhe të dhëna të vlefshme.</p> <p>Materia, vetitë dhe shndërrimet 2.1 Dallon dhe klasifikon lëndët sipas përbërjes, strukturës, vetive fizike dhe kimike, shndërrimeve dhe përdorimit të tyre në jetën e përditshme.</p> <p>Bota e gjallë 2.2 Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të varësisht nga kushtet të mjedisit, qëndrueshmërinë e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e involvuara në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.</p>	<p>Komunikues efektiv 1.6 Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe të saktë.</p> <p>Mendimtar kreativ dhe kritik 2.3 Harton planin e punës për realizimin e një krijimi/detyre duke përcaktuar fazat kryesore sipas fushës mësimore (letrar, shkencor, artistik).</p> <p>2.4 Zgjidh një problem (aritmetik, gjeometrik, gjuhësor, shoqëror, shkencor... etj.) të dhënë në formë tekstuale ose tekstuale e numerike, eksperimentale dhe arsyeton përzgjedhjen e procedurave përkatëse.</p>

— Planifikimi dhe përgatitja e gjithanshme

Zhvillimi i Planit të Sigurisë në Shkollë

MENDO
ME ZË

- ◆ Para se të vazhdoni më tutje, mund të shkruani në kënd të fletores se cilët mund të jenë hapat e mundshëm të planifikimit dhe përgatitjes tërësore në rast emergjence në shkollën tuaj.
- ◆ Mund të shkruani edhe numrin hapave të duhur për të ndërtuar planin e reagimit në rast emergjence për shkollën tuaj, le të themi, plani për sigurinë në shkollë.
- ◆ Pastaj ne do t'i krahasojmë idetë tuaja me elementet realë të Planit të Sigurisë.

Pas asaj, mund të hedhim një vështrim tek plani për sigurinë në shkollë. Mbani mend se mund ta quajmë edhe “Plani i reagimit për emergjencë” ose “Plani i menaxhimit të katastrofave në shkollë”.

Plani për
sigurinë
në shkollë

Hyrje

Vlerësimi i rrezikut

Inventari i kapaciteteve

Harta e shkollës me rrugë
për qasje për evakuim

Koha dhe orari

Përgjegjësitë e anëtarit
të KME-së

Pra, një plan tipik për sigurinë në shkollë ka gjashtë elemente kyçe.

ALBAN

Blerina, a mendon se dhe mësimdhënësi ka listuar të njëjtët elementë?

BLERINA

Po Alban, mendoj se po.

ALBAN

Po sikur të jenë krejt të ndryshëm nga ata që janë listuar në doracak?

BLERINA

As atëherë nuk do të ketë problem.

ALBAN

Ç'do të thuash?

BLERINA

Nëse mësimdhënësi ka listuar elementë të tjerë që nuk janë përmendur këtu, ai/ajo mund t'i ndajë me kolegët e vet të Komitetit për Menaxhimin e Emergjencave dhe të diskutojnë për ato komponentë. Nëse Komiteti pajtohet t'i përfshijë ata komponentë në Planin për Sigurinë e Shkollës, atëherë nuk ka problem.

ALBAN

Çfarë??? Ti po thua se komponentët e planit ndryshojnë?

BLERINA

Po, tërësisht. Ata varen krejt nga nevojat e shkollës.

ALBAN

Uau! Të faleminderit Blerina që ma shpjegove.

BLERINA

Me shumë kënaqësi.

MENDO
ME ZË

- ◆ Deri tani keni menduar për Planin Vjetër për Zhvillimin e Shkollës.
- ◆ Nëse tani jeni përfshirë në zhvillimin e Planit Vjetor për Zhvillimin e Shkollës, atëherë ky është lajm i mirë.
- ◆ Sepse e gjitha sfida qëndron tek përfshirja e RRD në Planin për Zhvillimin e Shkollës.
- ◆ Mund të hndodhë që kolegët nga shkolla apo komuna juaj të jenë skeptikë për mendimet tuaja por mbani mend se ata nuk e dinë atë çka ju dini tani.
- ◆ Prandaj, informojini ata vazhdimisht për arsyen se përse është e rëndësishme të kemi Plan për Sigurinë në Shkollë dhe pse është e rëndësishme që ai të bëhet pjesë e Planit Vjetor për Zhvillimin e Shkollës.
- ◆ Mbani mend se mund të jetë e vështirë, por nëse jeni të fokusuar dhe të përkushtuar mund ta bëni të pamundurën të mundur.
- ◆ Përpjekjet tuaja do të shpërblehen kur të keni shpëtuar jetë.



Sjellja e duhur

Sjellja e duhur në rast të rreziqeve potenciale

Tërmet

Veprimet që duhet të ndërmerren në rast të tërmeteve

- ◆ Mbajini nxënësit të qetë dhe të mos bien në panik.
- ◆ Nëse jeni në katin e epërm, futuni poshtë tryezave dhe rri aty derisa të mbarojë tërmeti.
- ◆ Nëse jeni në katin e epërm dhe nuk keni pranë asnjë tryezë, mbulojeni kokën me ndonjë send të trashë dhe qëndroni në ndonjë vend të sigurtë në klasë, p.sh. pranë ndonjë trari (mësimdhënësi duhet t'i informojë nxënësit paraprakisht për zonat më të sigurta në klasë).
- ◆ Nëse jeni në katin e parë të shtëpisë apo të shkollës, atëherë duhet të largoheni menjëherë nga ndërtesa duke e mbuluar kokën me ndonjë libër apo çantë shkolle dhe të dilni në zonë të hapur dhe të sigurtë.
- ◆ Gjatë tërmetit, rri larg dritareve, dyerve të jashtme dhe larg objekteve që mund të thërrmohen dhe t'ju lëndojnë.
- ◆ Mund t'ju evakujnë nga ndërtesa një e nga një, pa rënë në panik dhe pa e shtyrë njëri-tjetrin, duke mbuluar kokën me libër apo me çantë shkolle dhe ndihmoni të tjerët.
- ◆ Në rast se gjatë tërmetit jeni jashtë me nxënësit tuaj nuk duhet t'i lejoni nxënësit t'i afrohen shkollës apo të vrapojnë drejt shtëpisë për të marrë lodrën e preferuar apo ndonjë gjë tjetër. Ndërtesa mund të shembet dhe t'i lëndojë ata.

Zjarri

Veprimet që duhet të ndërmerren në rast të ndonjë incidenti me zjarr

- ◆ Në shkollë apo shtëpi ka rënë zjarr. Nëse doni të merrni dhe të përdorni fikësin e zjarrin, bëjeni duke e drejtuar nga burimi i zjarrit.
- ◆ Nëse nuk jeni në gjendje ta shuani zjarrin, menjëherë telefononi në 112 dhe ju tregoni adresën tuaj që zjarrfikësit të reagojnë menjëherë dhe të shuajnë zjarrin.
- ◆ Peshqiri pranë furrës ka marrë flakë. Menjëherë fikeni furrën dhe sigurohuni që nuk ka flakë dhe pastaj hidhni ujë mbi peshqirin që digjet.
- ◆ Ka shpërthyer zjarri dhe shtëpia është mbushur me tym. Duhet të dilni menjëherë nga shtëpia dhe të mbyllni të gjitha dyert.
- ◆ Ka shpërthyer zjarri, shtëpia është mbushur me tym dhe ju duhet të largoheni nga zjarri. Në fillim mbuloni hundën dhe gojën me një leckë dhe pastaj ikni.
- ◆ Ka shpërthyer zjarri, shtëpia është mbushur me tym dhe ju duhet të largoheni nga tymi. Meqë temperatura pranë dyshemesë është më e ulët dhe ka më shumë oksigjen, ju duhet të zbarriteni ose të rrotulloheni pasi ta keni mbuluar gojën. Mos harroni të mbyllni dyert.
- ◆ Kur largoheni nga ndonjë klasë apo shkollë ku ka zjarr duhet të tregoni vëmendje ndaj secilit nxënës dhe të siguroheni se dhe ata janë larguar me ju.
- ◆ Nëse edhe rrobat ju kanë marrë flakë duhet t'i hiqni menjëherë, nëse mundeni dhe t'i gjuani në një vend të sigurtë dhe pastaj të përpiqeni ta shuani zjarrin. Asnjëherë mos vraponi me rrobat në flakë sepse era e nxit zjarrin edhe më shumë.

Përmbytjet

Veprimet që duhen ndërmarrë në rast të përmbytjeve

- ◆ Në rast se zona është përmbytur mos lejoni asnjë nxënës të dalë nga ndërtesa.
- ◆ Në rast të përmbytjeve, çojeni çdo nxënës në katin e epërm dhe nëse është e mundur, në çati.
- ◆ Mos lejoni që nxënësit të përpiqen të ecin nëpër zonën e përmbytur apo të vozisin nëpër rrugë të përmbytura.
- ◆ Në rast se uji depërton brenda në ndërtesë, shkoni menjëherë në çati.
- ◆ Mos i lejoni fëmijët të largohen të pashoqëruar. Telefonojuni prindërve që të vijnë t'i marrin.
- ◆ Mbylleni burimin kryesor të energjisë nëse niveli i ujit brenda ndërtesës po rritet.
- ◆ Nëse keni rënë në kontakt me ujë nga përmbytja, lajini duart me sapun dhe ujë të disinfektuar dhe nëse është e mundur, bëni dush me ujë të pastër.

UDHËZIME TËRËSORE PËR ULJEN E RREZIKUT NGA KATASTROFAT DHE SIGURIA NË SHKOLLË

Pjesa II (Klasat 4, 5 dhe 6)



Alban, a i pe rreziqet potenciale në pjesën paraprake?

Po, Blerina. I pashë dhe tani vras mendjen çfarë duhet të bëjmë.



Mos u shqetëso Alban. Tani do të shohim si të jemi të sigurtë.



Me shokun tuaj plotësoni mozaikun



Të luajmë
me shokët.

Preje formën në
çdo pjesë dhe
sfido shokët t'i
bashkoni dhe të
gjeni mesazhin.



Mozaik 1: Tërmet



MESAZHI KRYESOR:

Në rast tërmeti, rreshtohuni dhe evakuoni ndërtesën drejt zonës së hapur dhe të sigurtë, si oborr ose hapësirë lojërash.



Mozaik 2: Përmytje



MESAZHI KRYESOR:

Në rast përmytjeje mos shkoni në ujë, por ngjituni në katin më të epërm të ndërtesës.



Mozaik 3: Zjarr



MESAZHI KRYESOR:

Në rast se shpërthen zjarr në ndërtesë, uluni në gjunjë dhe zvarrituni jashtë dhomës për t'u evakuuar nga ndërtesa në drejtim të një zone të hapur.



Mozaik 4: Dëborë



MESAZHI KRYESOR:


Kur ka reshje të rënda dëbore është më mirë të rri brenda ose nëse duhet të dilni, vishni rroba të ngrohta.





A je gati për
aktivitetin tjetër?
Shoqëroje Dorën
në zonën e sigurtë
teksa janë të
pranishëm të gjithë
rreziqet potencialë.

E pra, sa
mesazhe mundi
të identifikojë
shoku yt?



— Pjesa III (Klasa 7, 8 & 9)

Bashkë me shokët bëni hartën e shkollës

FAQE 71



A e di nëse shkolla yte ka identifikuar hartën dhe rrugët e evakuimit?

Le të bëjmë një hartë të shkollës dhe të gjejmë rrugët që mund të përdoren për evakuim në rast të emergjencës.



Për të bërë hartën e shkollës, ndiq këta hapa:

HAPAT PËR T'U NDJEKUR:

- ◆ Krijoni grupe me nga 4 deri 5 miq.
- ◆ Vizatoni çdo kat përfshirë dhe daljet.
- ◆ Identifikoni qartë rrugët e qasjes.
- ◆ Identifikoni zonën e sigurtë brenda shkollës.
- ◆ Identifikoni lokacionin e fikësve të zjarrit në çdo kat.
- ◆ Shkëmbeni planin tuaj me grupet e tjera.
- ◆ Finalizoni planin e përbashkët.
- ◆ Miratimi i planit nga zyra e Drejtorit.
- ◆ Postojeni skicën në tabelën e njoftimeve.

Gjeni këto fjalë

Pra, si shkoi
aktiviteti i skicimit?
Të shohim nëse
mund t'i gjeni
këto fjalë.



Ortek
Kapacitet
Katastrofë
Thatësi
Tërmet
Ekstrem
Përmbajtje
Rrezik
Rrëshqitje
Zbutje
Gatishmëri
Aftësi
Rrezik
Cënueshmëri

Y	B	T	I	U	C	E	H	P	K	U	P	Q	D	S	R	T	Ë	B
G	B	O	S	T	E	M	R	Ë	T	O	L	R	D	R	U	R	K	D
S	I	K	Ë	I	N	A	G	H	S	C	I	N	Ë	C	I	U	S	L
L	Q	E	Q	R	U	E	M	G	D	D	I	S	V	S	Y	B	P	D
B	R	H	E	W	E	T	T	L	H	D	H	Q	Ë	E	Z	F	Y	V
L	Z	O	K	R	S	L	E	J	P	Q	H	T	R	J	L	F	H	V
R	C	Y	T	E	H	C	E	T	I	O	A	E	U	T	X	O	L	J
K	I	G	A	M	M	D	L	T	I	H	T	B	U	U	H	G	P	E
G	I	M	F	S	Ë	B	J	C	T	C	A	E	X	B	K	P	D	K
Y	G	Z	Ë	H	R	E	W	R	O	E	A	Y	N	Z	K	O	S	S
W	J	B	E	K	I	Q	H	X	B	X	Z	P	M	C	Q	G	R	T
K	G	Q	J	R	Ë	C	W	Z	A	O	V	K	A	Y	I	B	P	R
P	G	C	Z	C	R	M	T	P	O	M	T	K	C	K	F	A	P	E
X	T	C	V	A	Z	R	B	L	M	C	G	H	E	R	Z	I	L	M
Z	V	S	Z	V	C	Q	B	Ë	C	S	R	Q	Q	V	S	O	O	L
W	I	S	V	I	R	Ë	M	H	S	I	T	A	G	Ë	L	P	J	S
L	V	E	A	Q	B	D	M	J	S	E	Z	T	T	J	U	U	L	C
G	S	Z	C	S	B	O	R	T	E	K	A	F	W	E	U	R	O	J
P	Ë	R	M	B	Y	T	J	E	X	T	A	J	Y	I	G	Y	H	L

A jeni të përgatitur ju dhe shkolla juaj?



Gjej sa e përgatitur është shkolla yte për të përballuar rreziqe potenciale? Përdore listën e kontrollit në vijim:

- Shkolla ime i ka identifikuar daljet emergjente.
- Harta e shkollës i përmban daljet emergjente dhe është postuar brenda shkollës.
- Harta tregon informacion kyç, si lokacioni, rrugët e qasjes dhe fikësit e zjarrit.
- Shkolla ime organizon prova çdo vit për të përgatitur nxënësit.
- Brenda ndërtesës së shkollës kemi një zonë të sigurtë.
- Shkolla ime ka Komitet për Menaxhim të Emergjencave. Komiteti është përgjegjës për evakuime në rast emergjence.

Në hartimin e doracakut morën pjesë disa organizata duke kontribuar dhe zhvilluar materiale, ndërsa të tjera morën pjesë si vëzhguese për të promovuar më tej koordinimin dhe bashkëpunimin. Më poshtë është paraqitur

lista e të gjitha organizatave të renditura sipas alfabetit, si dhe materialet apo programet shtesë që ato kanë rekomanduar në mbështetje të përpjekjeve për Mësimdhënia për Paqe dhe Ndërtim të Qëndrueshmërisë:

— Advocacy Training Resource Center

Profili: “ATRC ka një bibliotekë me publikime mbi çështje sociale, politike dhe ekonomike në lidhje me Kosovën dhe Ballkanin. Gjithashtu organizon debate publike dhe konferenca legjislativë mbi çështjet urgjente në Kosovë. ATRC gjithashtu ofron trajnime për të gjitha OJQ-të e Kosovës.”

Uebfaqja:
www.advocacy-center.org

Kontakti:
+383 38 244 810
info@advocacy-center.org

— British Council

Profili: “British Council është organizata ndërkombëtare e Mbretërisë së Bashkuar për marrëdhënie kulturore dhe mundësi arsimore. Ne krijojmë njohuri dhe mirëkuptim miqësor në mes të popullit të MB-së dhe vendeve të tjera.”

Materialet: British Council mbështet një gamë të gjerë të programeve sociale dhe arsimore përfshirë promovimin e qytetarisë aktive dhe mbështetjen e zhvillimit të studentëve në aftësi digjitale, zgjidhjes së problemeve dhe aftësive të të menduarit kritik. Ka gjithashtu në dispozicion online uebinare falas për profesorët e anglishtes.

Uebfaqja
<https://kosovo.britishcouncil.org>

Kontakti:
+383 38 243 292

— Cities of Peace

Profili: “Cities of Peace ekziston për të vazhduar, shenjuar dhe për t'u bërë zëri i thirrjes së shumë njerëzve: për të ndaluar luftën, konfliktin dhe dhunën kundër njerëzimit, kundër kombeve, kundër qyteteve.”

Materialet: Cities of Peace ka krijuar një kurrikul të bazuar në art për arsimin për paqe.

Uebfaqja:
www.citiesofpeace.org

Kontakti:
+1 631 329 0530
info@efiaf.org

Democracy Plus

Profili: "Qëllimi kryesor i organizatës sonë është të mbështesim vlerat dhe praktikat demokratike në fushën e qeverisjes së mirë, sundimit të ligjit, zgjedhjeve dhe partive politike, çështjeve sociale dhe të drejtave të njeriut."

Materialet: Materiale online për prindërit, profesorët dhe anëtarët e komunitetit për parandalimin e radikalizmit që çon në ekstremizëm të dhunshëm janë në proces e sipër.

Uebfaqja:
www.dplus-ks.org

Kontakti:
+383 38 749 288
info@dplus-ks.org

The Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

Profili: "Si ofrues i shërbimeve në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar për zhvillimin e qëndrueshëm dhe punën arsimore ndërkombëtare, ne jemi të përkushtuar për të krijuar një të ardhme me vlerë për të jetuar në gjithë botën."

Uebfaqja:
giz-kosovo-buero@giz.de

Kontakti:
+383 38 233 002 100
+383 38 233 002 172

forumZFD

Profili: forumZFD është Organizatë Ndërkombëtare Joqeveritare (INGO), e themeluar në Gjermani në vitin 1996. Ne punojmë në fushën e transformimit të konfliktit në Evropë, Lindjen e Mesme dhe Azinë Jug-Lindore. Si pjesë e programit të Ballkanit Perëndimor, mbështetur nga Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ), puna e forumZFD-së në Kosovë përqendrohet në temat e ballafaqimit me të kaluarën si dhe arsimit për paqe.

Uebfaqja:
www.forumzfd.de/en/western-balkans

Kontakti:
+383 38 749065
kosovo@forumZFD.de

Humanitarian Law Center Kosovo Fondi për të Drejtën Humanitare në Kosovë

Profili: "Për të mbështetur zbatimin e një kornize gjithëpërfshirëse të drejtësisë tranzicionale (DT) të përqendruar tek viktimat në Kosovë, në mënyrë që të rivendoset dinjiteti i viktimave dhe të kontribuohet në ndërtimin e paqes dhe ndërtimin e shtetit në Kosovë."

Materialet: FDHK, "Manuali mbi Drejtësinë Tranzicionale - Konceptet, Mekanizmat dhe Sfidat." Prishtinë, dhjetor 2015. Gjetet online.

Uebfaqja:
www.hlc-kosovo.org

Kontakti:
+383 38 243 488
+383 44 944 755
office@hlc-kosovo.org

Kosovo Advocacy Development Center Qendra Kosovare për Zhvillim të Avokimit

Profili: "Përmirësimi i jetës duke informuar, përfshirë dhe fuqizuar zërin publik në politikat e shëndetit, mjedisit dhe proceset e vendimmarrjes." Sa i përket arsimit, KADC përqendrohet në shëndetin publik, sportet në shkolla dhe arsimin për paqe.

Uebfaqja:
www.kadc-ks.org

Kontakti:
+383 44 188 366
+383 44 207 215

Kosovo Center for Security Studies Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

Profili: "QKSS është e përkushtuar në zhvillimin dhe reformën e sektorit të sigurisë në Kosovë dhe Ballkanin Perëndimor. Gjatë gjithë kohës promovon parimet e qeverisjes së mirë, integritetit dhe qëndrueshmërisë (resilience)".

Materialet: Raporte të shumta dhe publikime janë në dispozicion online, përfshirë: Perteshi, Skender. "Udhëzuesi i gazetarëve - Ekstremizmi i dhunshëm: Definicioni dhe terminologjia", Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, e mbështetur nga Ambasada e SHBA në Prishtinë. 23 maj 2018.

Perteshi, Skender. "Përtej ngacmuesit: kërcënime të reja të ekstremizmit të dhunshëm në Kosovë". Qendra e Kosovës për Studime të Sigurisë, e mbështetur nga Ambasada e Mbretërisë së Hollandës. 16 tetor 2018.

Uebfaqja:
www.qkss.org

Kontakti:
+383 38 221 420
info@qkss.org

Kosovo Education Center Qendra për Arsim e Kosovës

Profili: "QAK është përqendruar kryesisht në trajnimin e stafit shkollor në lidhje me metodologjitë dhe lidhshimin e ri të mësimdhënies. Për më tepër, QAK është aktive në fusha të tjera që mbështesin avancimin e cilësisë së arsimit në Kosovë."

Materialet: QAK ka një shumëllojshmëri të gjerë të materialeve në dispozicion në faqen e tyre të internetit, përfshirë raportet dhe vlerësimet, si dhe udhëzuesit dhe manualët për mësuesit, prindërit dhe studentët për tema të tilla si siguria në internet, të drejtat e njeriut dhe drejtësia sociale.

Uebfaqja:
kec-ks.org

Kontakti:
+383 38 244 257
+383 38 258 203
office@kec-ks.org

Oxfam

Profili: “Oxfam është një zë global mbi varfërinë dhe pabarazinë, të drejtat e grave, çështjet humanitare dhe ndryshimet klimatike.”

Materialet: Oxfam Education ofron një gamë të gjerë idesh, resursesh dhe mbështetje për zhvillimin e mësimit global në klasë dhe në tërë shkollën. Materialet mund të gjenden në faqen e tyre të internetit, më poshtë.

Uebfaqja:
www.oxfam.org.uk/education

Kontakti:
education@oxfam.org.uk

Peace Corps Korpusi i Paqes

Profili: “Vullnetarët në Kosovë punojnë me komunitetet e tyre në arsim dhe projekte të zhvillimit ekonomik të komunitetit. Gjatë shërbimit të tyre në Kosovë, Vullnetarët mësojnë të flasin gjuhët lokale, përfshirë shqip dhe serbisht.”

Uebfaqja:
www.peacecorps.gov/kosovo

Kontakti:
+ 383 38 712 770
kosovo@peacecorps.gov

Play International

Profili: “PLAY International intervenon në Kosovë që nga viti 2002 për të promovuar pajtimin ndëretnik dhe përfshirjen sociale të të rinjve, veçanërisht grupet e marginalizuara (zonat rurale, pakicat, etj.). Aktivitetet sociale-sportive të propozuara nga PLAY International janë krijuar për të përfshirë të gjitha grupet në shoqëri pa marrë parasysh origjinën etnike, gjininë ose aftësitë individuale.”

Uebfaqja:
www.pl4y.international/en/impact/in_the_field/kosovo.html

Kontakti:
+383 44 946 091
Andrew Piner, Head of Mission:
cdm@pl4y.international

United Nations Development Programme Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara

Profili: “Në Kosovë që nga viti 1999, UNDP ka fituar reputacion si partner i pavarur dhe me përvojë në përpjekjet kolektive për të ndërtuar dhe forcuar institucionet e Kosovës dhe për të arritur zhvillim të qëndrueshëm.”

Materialet: Parandalimi i Ekstremizmit të Dhunshëm Doracak për Profesorët, maj 2018. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Kosovë. Mbështetur nga Ambasada e Italisë në Kosovë.

Uebfaqja:
www.ks.undp.org

Kontakti:
+383 38 249 066
registry.ks@undp.org

United Nations Children's Fund - UNICEF Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijë - UNICEF

Profili: “Në Kosovë synon të sigurojë që të gjithë fëmijët, pa marrë parasysh prejardhjen e tyre socio-ekonomike ose etnike, të kenë qasje në shërbime cilësore dhe mundësi për t'i ndihmuar ata të mbijetojnë, të zhvillohen, të pasurojnë potencialin e tyre dhe të bëhen qytetarë aktivë dhe të përgjegjshëm të komuniteteve të tyre.”

Uebfaqja:

www.unicef.org/kosovoprogramme

Kontakti:

+383 38 249 230

+383 38 249 231

+383 38 249 232

prishtina@unicef.org

U.S. Agency for International Development Agjencia për Zhvillim Ndërkombëtar e SHBA-ve

Profili: “Në emër të popullit amerikan, ne promovojmë dhe demonstrojmë vlerat demokratike jashtë vendit dhe punojmë drejt një bote të lirë, paqësore dhe prosperuese. Në mbështetje të politikës së jashtme të Amerikës, Agjencia për Zhvillim Ndërkombëtar e Shteteve të Bashkuara drejton Qeverinë Amerikane drejt zhvillimit ndërkombëtar dhe siguron asistencë për katastrofë përmes partneriteteve dhe investimeve që shpëtojnë jetë, ulin shkallën e varfërisë, forcojnë qeverisjen demokratike dhe ndihmojnë njerëzit të dalin nga krizat humanitare dhe të avancojnë përtej ndihmës së dhënë.”

Uebfaqja:

www.usaid.gov/kosovo

Kontakti:

www.usaid.gov/contact-us

DORACAK I KURRIKULËS SË
MËSIMDHËNIES PËR PAQE
DHE NDËRTIM TË QËNDRUESHMËRISË
(RESILIENCE)

Përkthimi

LBG Communications

Dizajni

Milky Way Creative

Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

373.3.016(035)

Founds, Emma

Doracak i kurrikulës së mësimdhënies për paqe dhe ndërtim të qëndrueshmërisë (RESILIENCE) :
arsimi i mesëm i ultë / Emma Founds...[et al.]. - Prishtinë : Ministria e Arsimit,
Shkencës dhe Teknologjisë, 2020. - 82 f. : ilustr. ; 30 cm.

1. Llapashtica-Lipscomb, Feime
2. Gashi-Ramadani, Shqipe
3. Saliu, Arbër

ISBN 978-9951-16-124-4



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria e Kosovës-Vlada Kosova-Government of Kosova
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
Ministarstvo Obrazovanja Nauke i Tehnologije
Ministry of Education, Science and Technology

DORACAK I KURRIKULËS SË
**MËSIMDHËNIES PËR PAQE
DHE NDËRTIM TË QËNDRUESHMËRISË
(RESILIENCE)**

ARSIMI I MESËM I ULËT